



**MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME
INSPEKTORATI POLICOR I KOSOVËS
DEPARTAMENTI I INSPEKTIMEVE**



REPUBLIKA E KOSOVES
REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO

INSPEKTORATI POLICOR I KOSOVES
POLICUSKI INSPEKTORAT KOSOVA / POLICE INSPECTORATE OF KOSOVO

Hajvali - Prishtine

Nr. / Br. 04-116-992/3

Data / Datum 26.01.2022

**RAPORT I INSPEKTIMIT
"MENAXHIMI I HETIMIT DHE ZBULIMIT TË KRIMIT"
(stacionet policore të kategorisë A)**

Nr. 9/2021

Prishtinë, 26 janar 2022

Informata të përgjithshme

Titulli	Raport i inspektimit Menaxhimi i hetimit dhe zbulimit të krimit
Data e përgatitjes	26 janar 2022
Realizuar nga	Ragip Rexhepi, udhëheqës i ekipit të inspektimit, Lenart Berisha, inspektor, Fitore Gajraku, inspektor
Mbikëqyrur nga	Ilir Idrizaj, mbikëqyrës i inspektimit, Udhëheqës i Divizionit të Inspektimit dhe Raportimit
Mbështetur nga	Bujar Mustafa, Udhëheqës i Divizionit për Analizë, Planifikim dhe Cilësi
Dorëzuar nga	Bekim Pira, Udhëheqës i Departamentit të Inspektimit
Miratuar nga	Kushtrim Hodaj, Kryeshef Ekzekutiv, Inspektorati Policor i Kosovës
Data e miratimit	26 janar 2022



© Të drejtat e autorit të Inspektoratit Policor të Kosovës.

Teksti i këtij dokumenti mund të riprodhohet falas në çdo format ose medium, me kusht që të riprodhohet me saktësi dhe jo në një kontekst ndryshe nga se raportohet këtu.

Ky material duhet të njihet si e drejtë e autorit (IPK) dhe dokumenti si titulli i specifikuar.

Kur është identifikuar materiali nga pala e tretë, leja nga mbajtësi i të drejtës së autorit duhet të kërkohet. Çdo pyetje në lidhje me këtë publikim duhet të na dërgohet në:

Inspektorati Policor i Kosovës,
Rruga “Dëshmorët e Gollakut”, p.n, Hajvali, Prishtinë,
Tel: 038 200 19 691,+383 (0)38 521 201
E-mail: zimp.ipk@rks-gov.net

1. Përmbledhja ekzekutive

- 1.1. Informacion i përgjithshëm mbi rezultatet e inspektimit.....(4-5)

2. Hyrje

- 2.1. Arsyet e inicimit të inspektimit.....(6-6)
2.2. Qëllimi.....(6-6)
2.3. Objektivat e inspektimit.....(6-6)
2.4. Rëndësia e inspektimit.....(7-7)
2.5. Metodologjia e inspektimit.....(7-8)

3. Përshkrimi i objektit, gjetjet dhe rekomandimet

- 3.1. Organizimi dhe kapacitetet hetimore.....(9-10)
3.2. Indikatorët e performancës në hetimin dhe zbulimin e krimit.....(10-14)
3.3. Aktivitetet policore në hetimin dhe zbulimin e krimit.....(14-19)
3.4. Trajtimi i dëshmive.....(19-25)

4. Plani për përmbushjen e rekomandimeve

- 4.1. Plani i veprimit për realizimin e rekomandimeve.....(26-30)

Shtojcat

1. Përmbledhja ekzekutive

1.1. Informacion i përgjithshëm mbi rezultatet e inspektimit (gjetjet kryesore)

1.1.1. Policia e Kosovës është e mandatuar për të parandaluar, hetuar dhe zbuluar krimin brenda shoqërisë. Kjo forcë policore ka të organizuar struktura hetimore në tre nivele të organizimit të saj dhe secila nga to ka të ndarë kompetencën lëndore. Struktura hetimore e nivelit lokal përbëhet nga ekipe hetuesish, krim teknikësh e administrues të dëshmimeve dhe brenda tyre ka një ndarje të qartë përgjegjësish dhe detyrash hetimore. Janë hasur gjashtë (6) raste në sektorët hetimor të stacioneve policore të kategorisë A, kur drejtuesit, apo mbikëqyrësit ushtrojnë detyra në pozita jo ekuivalente me gradat që mbajnë ata. Sa i përket zhvillimit të vazhdueshëm profesional, 75% e punonjësve të sektorëve hetimor të kësaj kategorie stacionesh policore kanë përfunduar kursin bazik të hetimeve, kurs ky në të cilin duhet të jetë i përfshirë i gjithë stafi hetimor. Kurse, sa i përket trajnimeve lidhur me trajtimin e dhunës në familje dhe krim teknikë, vlerësohet se përmbushen nevojat e personelit të angazhuar në këto detyra. Nevojitet të ketë përfshirje më të madhe të numrit të administruesve të dhomave të dëshmimeve në trajnime përkatëse.

1.1.2. Në vitin 2020 kishte rënie për 6.1% të trendit të krimit në zonat e përgjegjësive së drejtorive policore, si rezultat edhe i reduktimit të lëvizjes së qytetarëve përshkak të masave kundër Covid-19, kurse më të ngarkuarat me raste kanë qenë Prishtina, Peja, Prizreni dhe Ferizaj. Zbulueshmëria e rasteve në nivel të të gjitha drejtorive në vitin 2019 ka qenë 64%, derisa në vitin 2020 ka rënë në 60%. Më efektive në zbulimin e veprave penale ka qenë Peja me 74%, përkatësisht 73%. Prishtina ishte regjioni me numrin më të madh të krimeve, me ngarkesë më të madhe rastesh për polic dhe me numër më të madh rastesh në 1.000 banorë. Në nivel të zonave të përgjegjësive së 13 stacioneve të kategorisë A, në vitin 2020 ka pasur rënie të numrit të krimeve për 2.5%. Zona e përgjegjësive e kontrolluar nga Stacioni Policor - Prishtinë Jugu mbetet zona më e prekur nga krimi përgjatë dy viteve 2019-2020 derisa më së paku e prekur mbetet zona e përgjegjësive e kontrolluar nga Stacioni Policor në Leposaviq. Në vitin 2020 është shënuar një trend negativ me rënie të zbulueshmërisë së rasteve në kuadër të këtyre stacioneve për 4.1%, krahasuar me vitin paraprak. Gjatë vitit 2019 janë zbuluar 57% e rasteve në nivel të kësaj kategorie stacionesh, kurse në vitin 2020, 56% e rasteve të raportuara. Leposaviqi e Peja kanë shkallën më të lartë të zbulueshmërisë gjatë vitit 2019 me 80%, përkatësisht 69%, derisa në vitin 2020, Leposaviqi dhe Mitrovicë Veriu me 80%, përkatësisht 76% të rasteve. Sektorët e hetimeve në kuadër të stacioneve në Leposaviq dhe Mitrovicë Veriu kanë burime më të mjaftueshme për të trajtuar më me komoditet rastet nën administrim, që janë më të pakta krahasuar me ato të stacioneve tjera. Janë identifikuar disa stacione policore që kanë pasur mbingarkesë me numër rastesh në raport me numrin e hetuesve. Gjatë viteve 2019-2020, një hetues policor ka administruar 62 - 64 raste penale. Më së shumti ngarkesë rastesh ka evidentuar Stacioni Policor në Fushë Kosovë dhe Prizren (93 - 96 raste, përkatësisht 82 - 86 raste), derisa më së paku Stacioni Policor në Leposaviq dhe Mitrovicë Veriu (10 raste, përkatësisht 16 - 18 raste për hetues).

1.1.3. Lidhur me evidentimin e informatave në Sistemin Informativ të Policisë së Kosovës (SIPK) janë hasur disa lëshime që kanë të bëjnë me saktësinë e tyre apo mangësinë e tyre. Është hasur një zyrtar i bazës së të dhënave (SIPK) duke punuar edhe pse nuk ka leje të sigurisë për nivelin përkatës meqë nuk ka plotësuar kriteret nga verifikimi i realizuar nga AKI-ja. Në të gjitha dosjet e mostruara nuk janë hasur raportet njoftuese për Prokurorin e Shtetit mbi dyshimin e arsyeshëm të veprës penale (neni 70, paragrafi 5 i Kodit të Procedurës Penale - KPP). Janë hasur disa deklarata në dosje

penale që nuk i përmbajnë të drejtat e rezervuara të palëve (të dyshuarve dhe dëshmitarëve), ose të drejtat e palëve nuk janë konform neneve të KPP-së, por edhe të panënshkruara nga palët. Janë hasur duke u përdorur në shumë raste edhe formularë dhe shkresa jo unike në kuadër të dosjeve. Në shumicën e dosjeve penale nuk janë hasur pakot informuese të viktimave. Kallëzimet penale përmbajnë elementet e nevojshme për rastet, kurse procedimi i tyre në Prokurori ndodhë diku në të 37 ditë kalendarike, kohë kjo e nxjerrur nga 130 mostra (Peja ka kohën mesatare prej 15 ditësh). Afërsisht gjysma e dosjeve të mostruara kanë të bashkëngjitur të kaluarën kriminale të personave të dyshuar. Janë hasur 89 raste kur nuk është respektuar zinxhiri komandues që dosjet penale (kallëzimet penale) t'i nënshtrohen kontrollit dhe të nënshkruhen nga mbikëqyrësit para procedimit të tyre në Prokurori.

1.1.4. Në disa dhoma të dëshmime janë hasur dëshmi që nuk ruhen të ndara në vende të posaçme siç parashihet me PSO. Lidhur me paketimin e dëshmime, janë hasur 43 sosh pa shirit bllobues, por edhe 26 dëshmi të paketuar në paketim joadekuat. Ka raste kur janë hasur sende të deponuara që nuk kanë qenë rezultat i konfiskimit e që nuk janë të regjistruar në regjistra. Dhomat e dëshmime mbajnë regjistra të dëshmime dhe databazat. Ka raste kur regjistrimi nuk është bërë ekuivalent në të dyjat evidencat, ose edhe kur ka mospërputhje të dhënash në mes të regjistrit dhe zinxhirit të ruajtjes. Në dy (2) raste nuk janë prezentuar zinxhirët e ruajtjes për dëshmitë e deponuara dhe në dy (2) të tjera ka mospërputhje ndërmjet numrit të dëshmime fizike, me informatat në Regjistrin e dëshmime, zinxhirin e ruajtjes dhe listën e dëshmime. IPK-ja ka hasur edhe në dobësi lidhur me identifikimin e dëshmime që duhet të jetë i rregulluar përmes një sistemi numrash. Në gjashtë (6) dhoma të dëshmime janë hasur lëvizje të 16 dëshmime pa u evidentuar në regjistra. Lidhur me qasjen në dhomat e dëshmime, shtatë (7) prej tyre nga gjithsej 13 të mostruara kanë respektuar procedurën e kufizimit të qasjes në çelësat e dhomave të dëshmime. Me gjithë avansimin e kushteve brenda dhomave të dëshmime janë hasur disa dobësi që shtrojnë nevojën e përmirësimit të vazhdueshëm e që lidhen me monitorimin, alarmin, detektorët, higjienën, etj. Megjithëse dëshmitë kërkojnë kujdesje të vazhdueshme, lidhur me to po ngecin kontrollet nga radhët e mbikëqyrësve. Kontrollet përmes revizioneve, inventarizimeve dhe inspektimeve po organizohen pak ose fare dhe kjo shtron nevojën për mobilizim të vazhdueshëm të menaxherëve në ngritjen e kontrollit mbi dëshmitë.

2. Hyrje

2.1. Arsyet e inicimit të inspektimit

2.1.1. Departamenti i Inspektimit ka filluar punën në korrik të vitit 2006, kur është themeluar dhe vet agjencia. IPK synon të shtojë vlerë dhe të forcojë besimin e publikut në Policinë dhe këtë e bën përmes shqyrtimit të pavarur e raportimit objektiv. Në bazë të Ligjit nr. 03/L-231, IPK ka mandat ligjor që të kryej inspektime në Polici, për të vlerësuar mënyrën e kryerjes së detyrave. Ky aktivitet mbikëqyrës ndihmon dhe mbështetë Policinë për të siguruar një shërbim profesional, demokratik e të përgjegjshëm. Plani Vjetor i Inspektimeve të Rregullta për vitin 2021 ka paraparë kryerjen e një varg inspektimesh në disa fusha të menaxhimit, përfshirë dhe atë të menaxhimit të hetimit dhe zbulimit të krimit. IPK-ja ka kryer dhe më parë inspektime tematike të kësaj fushe, por inspektimet e fundit kanë pasur fokus hetimet në nivel të sektorëve rajonal dhe njësisive qendrore. Ka kaluar një periudhë e gjatë që fokus i inspektimit nuk kanë qenë sektorët e hetimeve në kuadër të stacioneve.

2.1.2. Inspektimi paraqet interes për IPK-në, me qëllim të vlerësimit nëse stacionet kanë strukturë funksionale, kapacitete njerëzore/teknike e profesionale, për të adresuar shqetësimet e komunitetit lidhur me krimin në shoqëri dhe dukuritë tjera negative. Përmes inspektimit synohet të vlerësohen angazhimet në ngritjen e shkallës së zbulueshmërisë së krimeve të ndodhura. Duke konsideruar se inspektimi paraqet një instrument shumë të suksesshëm për të vlerësuar trajtimin e kësaj fushe të menaxhimit, Kryeshefi Ekzekutiv i IPK-së me datën 28 maj 2021, mbi bazën e Programit të punës inspektuese, ka iniciuar inspektim për të vlerësuar performancën e stacioneve policore të kategorisë A, në këtë fushë menaxhimi. Inicimi i inspektimit është ndikuar edhe nga nevoja që të vlerësohet përkushtimi dhe serioziteti i njësisive hetimore në reduktimin e kriminalitetit, në drejtim të forcimit të sundimit të rendit e ligjit. Inspektimi ofron një mundësi për të vlerësuar edhe llogaridhënien dhe profesionalizmin e strukturës hetimore në trajtimin e duhur të rasteve hetimore.

2.2. Qëllimi i inspektimit

2.2.1. Qëllimi i këtij inspektimi ka qenë:

- Që të përcaktojë nëse ligjet, rregulloret, parimet e procedurat policore zbatohen si duhet dhe nëse janë të përshtatshme për të arritur qëllimet;
- Që të përcaktojë nëse burimet policore shfrytëzohen në mënyrë efektive, efikase dhe se janë të përshtatshme për të arritur qëllimet dhe objektivat policore;
- Që të jepet një opinion objektiv mbi çështjet që lidhen me hetimin dhe zbulimin e krimit;
- Që të identifikoj mangësitë-dobësitë dhe të rekomandoj masa për funksionim më të mirë;
- Që të parandalojë shkeljet eventuale që mund të kryhen gjatë punës në fushën përkatëse.

2.3. Objektivat e inspektimit

2.3.1. Objektivat që ka synuar t'i arrijë ky inspektim janë:

- Të vlerësohet kapacitetet në fushën e hetimit të krimit;
- Të vlerësohet respektimi i rregullave e procedurave në hetimin dhe zbulimin e krimit;
- Të vlerësohet dokumentimi i vendngjarjes dhe trajtimi i dëshmitarëve që lidhen me krimin;
- Të vlerësohet respektimi i të drejtave të viktimave dhe të dyshuarve në procedurë; dhe
- Të analizohen dhe vlerësohen indikatorët e performances në luftimin e krimit.

2.4. Rëndësia e inspektimit

2.4.1. Inspektimi në këtë fushë të menaxhimit luan rol të rëndësishëm në:

- Ngritjen e profesionalizmit dhe përkushtimit të personelit, për të siguruar shkallë më të lartë të efikasitetit në hetimin dhe zbulimin e veprave penale;
- Ngritjen e përgjegjësisë në respektimin e rregullave e procedurave për hetimin e krimit;
- Ngritjen e vetëdijes për të zhvilluar qasje aktive në parandalimin e zvogëlimin e krimit;
- Ngritjen e integritetit policor gjatë trajtimit të rasteve në kompetencë të stacioneve;
- Ngritjen e besimit të qytetarëve në autoritetet hetimore mbi hetimin e zbulimin e krimit;
- Sigurimin e qasjes parimore në respektimin e të drejtave dhe lirive të viktimave dhe të dyshuarve.

2.5. Metodologjia e inspektimit

2.5.1. Në këtë inspektim është vlerësuar menaxhimi i hetimit dhe zbulimit të krimit, me fokus të veçantë nga njësitë hetimore të stacioneve policore të kategorisë A. Inspektimi është përqendruar në të gjitha stacionet policore të kategorisë A, në të gjitha drejtoritë rajonale në kuadër të Divizionit të Sigurisë Publike të Departamentit për Operacione. Gjetjet e këtij inspektimi janë me interes për zyrtarët hetues të stacioneve policore në nivel lokal, si dhe nivelin mbikëqyrës e vendimmarrës.

2.5.2. Gjatë inspektimit është aplikuar metodologji adekuate inspektuese, e cila ofron mundësi për të siguruar informacionin e nevojshëm në interes të nxjerrjes së opinionit objektiv mbi proceset e fokusuar. Në këtë drejtim:

- a) Janë zhvilluar takime- intervista me 13 drejtues, punonjës e bartës funksionesh, përfshirë: Shefat e Sektorëve të Hetimeve në kuadër të stacioneve policore të kategorisë A (Ferizaj, Gjakovë, Gjilan, Mitrovicë Jugu, Mitrovicë Veriu, Leposaviq, Pejë, Prishtinë Qendër, Prishtinë Jugu, Prishtinë Veriu, Podujevë, Fushë Kosovë dhe Prizren Alfa);
- b) Janë kryer inspektime - kontrole fizike të: dosjeve hetimore, dëshmime mbi mënyrën e trajtimit (130 sosh), kushteve fizike e sigurisë së dhomave të dëshmime, si dhe evidencave fizike dhe elektronike të dëshmime;
- c) Janë përdorur formularë standard të verifikimit të: kapaciteteve e sistemimit të burimeve njerëzore, kushteve fizike e të sigurisë në dhomat e dëshmime, si dhe trajtimit të dëshmime që lidhen me rastet e mostruara;
- d) Janë marrë dokumente të shkruara, si: raporte vjetore të sektorëve hetimor (2019/2020), kopjet e dosjeve penale (130 dosje hetimore, nga të cilat, nga 10 lëndë për secilin sektor hetimor për vitet 2019-2020, kopjet e zinxhirëve të ruajtjes dhe evidencave të dëshmime, raportet lidhur me revizionin/inventarizimin dhe inspektimin e dhomave të dëshmime, etj.

2.5.3. Bazuar në Programin e punës inspektuese, inspektimi ka filluar më 31.05.2021 dhe është planifikuar të përfundojë më 23.07.2021, por për shkak të rrethanave të krijuara nga Pandemia me Covid-19 dhe takimeve konsultuese me zyrtarët përgjegjës policor, faza e punës inspektuese në terren është prolonguar. Inspektimi është përqendruar në vlerësimin e kryerjes së detyrave policore gjatë periudhës dy vjeçare (2019/2020) dhe gjendjen aktuale.

2.5.4. Për përmbushjen e objektivave, inspektimi është fokusuar në këto drejtime kryesore:

- Organizimi dhe kapacitetet,
- Respektimi i rregullave dhe procedurave hetimore;
- Bashkëpunimi me Prokurorinë e Shtetit,
- Respektimi i të drejtave të palëve në procedurë;
- Performanca e njësisive hetimore në hetimin dhe zbulimin e krimit,
- Trajtimi i dëshmive në stacione policore.

2.5.5. Dokumentet në vijim janë baza themelore (standartet), në të cilën është mbështetur puna e inspektorëve, gjatë vlerësimit të kryerjes së detyrave:

- Kodi Penal i Republikës së Kosovës,
- Kodi i Procedurës Penale,
- Ligji i Policisë,
- Procedura Standarde e Operimit- Procedimi i lëndëve dhe kompetenca lëndore e hetimit
- Procedura Standarde e Operimit- Sektori i vendit të ngjarjes;
- Procedura Standarde e Operimit- Dhomat e dëshmive;
- Procedura Standarde e Operimit- Hetimi i dhunës familjare;
- Formularët standard të dosjes hetimore.

2.5.6. Gjatë punës në terren dhe pasqyrimin të gjetjeve në raportin e zgjeruar të inspektimit, nuk është hasur në ndonjë vështirësi që do të ndikonte në përmbushjen me sukses të objektivave të vëna me Programin e punës. Inspektorët kanë hasur në një bashkëpunim të kënaqshëm të personelit policor. Raporti përfundimtar iu ka nënshtruar proceseve të brendshme të kontrollit të cilësisë. Po ashtu, është realizuar dhe një takim me përfaqësues të strukturës policore, ku janë diskutuar gjetjet, rekomandimet dhe Plani i Veprimit të përmbushjes së tyre (25.01.2022).

3. Përshkrimi i objektit, të gjeturat dhe rekomandimet

3.1. Organizimi dhe kapacitetet hetimore

3.1.1. Policia ka mandat ligjor, veç tjerash edhe të parandaloj dhe zbuloj veprat penale dhe kryesit e tyre, dhe në këtë drejtim edhe të hetoj veprat penale dhe kryesit e tyre. Hetimi i veprave penale realizohet në tre nivele, përfshirë nivelin qendror, rajonal dhe atë lokal. Lidhur me hetimet, janë të ndara kompetencat lëndore dhe ato territoriale. Lidhur me kompetencën lëndore, stacionet policore trajtojnë veprat penale të përcaktuara me Kodin Penal të Republikës së Kosovës, të cilat më tutje janë specifikuar edhe në Procedurat Standarde të Operimit - Procedimi i lëndëve dhe kompetencat lëndore të hetimit, të miratuara më 10.07.2013. Kjo e fundit është rishikuar më pas dhe nga data 25.08.2020, Policia e Kosovës shërbehet me PSO-në e re, me të njëjtin titull. Mbi bazën e këtyre procedurave, stacioneve policore iu janë lënë në kompetencë hetimore, kategoritë e veprave penale më të lehta për nga pesha dhe rrezikshmëria që bartin ato (*Lista e veprave penale që hetohen nga sektorët e hetimeve në stacione është e bashkëngjitur në shtojcë të këtij Raporti*). Meqë inspektimi ka në fokus stacionet policore, IPK-ja kësaj radhe ka trajtuar veprimet policore në nivel lokal të hetimit të rasteve penale. Stacionet policore sipas organizimit të brendshëm kanë në kuadër të tyre sektorë të veçantë hetimor, madhësia dhe kapacitetet njerëzore, të të cilave varen nga kategoria e stacioneve. Departamenti i Inspektimit është marrë me fokus të veçantë me njësitë e hetimeve të stacioneve policore të kategorisë A, që konsiderohet se janë më të ngarkuar me trajtimin e rasteve të raportuara penale. Sipas Strukturës organizative të Policisë, sektorët e hetimeve në stacione të kategorisë A përbëhen nga ekipe hetuesish dhe të teknikës kriminalistike. Çdo sektor hetimor ka edhe zyrtarët përgjegjës për administrimin e dhomave të dëshmimeve. Sektorët hetimor parashihet të udhëhiqen nga shefat me gradë kapiten, që për punën e tyre raportojnë tek komandantët.

3.1.2. Sektorët hetimor të 13 stacioneve policore të kategorisë A kanë të angazhuar gjithsej 239 zyrtarë të uniformuar, përfshirë këtu edhe stafin drejtues sektorial. Nga pikëpamja e sistemimit të personelit, 11 nga 13 sektorë hetimor udhëhiqen nga punonjës me gradën kapiten, derisa dy të tjerë udhëhiqen nga punonjës me gradë më të ulët se që parashihet me Strukturë (në Ferizaj e Podujevë, sektorët e hetimeve udhëhiqen nga punonjës me gradë toger, të cilësuar si raste me mospërputhje gradë - pozitë). Po ashtu, janë identifikuar edhe katër (4) raste të tjera, ku në pozita të mbikëqyrësve janë sistemuar punonjës me grada jo adekuate (në tre raste në Mitrovicë Veriu, mbikëqyrësit e ekipeve të hetimeve janë policë edhe pse parashihet që këto pozita të udhëhiqen nga punonjës me gradë rreshter, po ashtu në Leposaviq është hasur një rast i tillë). Në disa prej stacioneve policore nuk janë të angazhuar mbikëqyrësit e ekipeve të krim teknikës dhe kanë vetëm zyrtarë të teknikës kriminalistike. Numri i hetuesve dhe zyrtarëve të teknikës kriminalistike ndryshon nga stacioni në stacion. Si rezultat i kësaj, në disa prej stacioneve, hetuesit kanë ngarkesa më të mëdha me raste, gjë që mund të reflektoj edhe në performancën e tyre. Stacionet policore kanë të angazhuar edhe zyrtarë të administrimit të dhomave të dëshmimeve, ku numri i tyre ndryshon nga 1 deri në 2 zyrtarë për sektor hetimor. Kësaj radhe nuk janë hasur situata të ushtrimit të detyrave me ushtrues detyre.

3.1.3. Zhvillimi i vazhdueshëm profesional kërkon organizimin e trajnimeve, të cilat duhet të jenë të vazhdueshme, me qëllim që punonjësit të njihen me metodat e reja të punës efikase, praktikat e avansuara dhe të freskojnë njohuritë e shkathtësitë e tyre në ngritjen e performancës në punë. Në këtë drejtim, IPK-ja ka verifikuar nëse struktura hetimore është e pajisur me njohuri të nevojshme përmes programeve trajnuese. Andaj, të gjithë punonjësit e angazhuar në sektorët hetimor nevojitet


të kenë të kryer kursin bazik të hetimit të krimit. Inspektimi vë në pah se jo të gjithë punonjësit e strukturës hetimore kanë të kryer këtë kurs. Nga 239 punonjës të strukturës hetimore të stacioneve policore të kategorisë A, 179 prej tyre kanë të përfunduar kursin bazik të hetimit të krimit. Numrin më të madh të hetuesve me kurs të kryer të hetimit të krimit e kanë sektorët hetimor nga stacionet policore në Pejë dhe Prishtinë Qendër. Situata më e palakmueshme sa i përket vijimit të këtij kursi ekziston në sektorët hetimor të stacioneve policore në Prishtinë Jugu dhe Mitrovicë Veriu. Është e njohur se sektorët e hetimeve në stacione ballafaqohen me numër të madh të rasteve të ushtrimit të dhunës në familje. Meqë këta sektorë angazhohen në trajtimin e këtyre rasteve, është logjike që personeli i angazhuar të jetë i pajisur me njohuritë e nevojshme nga kjo fushë. PSO-të nga fusha e hetimit të dhunës në familje përcaktojnë që stacionet policore do të angazhojnë hetuesit primar për trajtimin e rasteve të tilla. Për trajtimin e dhunës në familje janë të trajnuar 92 hetues në kuadër të sektorëve hetimor të kësaj kategorie stacionesh policore edhe pse me trajtimin e rasteve të tilla merret ekskluzivisht një numër më i vogël i hetuesish policor. Ky numër paraqet një shifër pozitive dhe që është në rritje e sipër. Në kuadër të çdo sektori hetimor janë të angazhuar nga dy (2) deri në tre (3) hetues të dhunës në familje. Siç u potencua edhe më lartë, këta sektorë kanë edhe ekipe të teknikës kriminalistike. Janë 38 punonjës që kanë të kryer kurset e nevojshme për krim teknikë, forenzikë dhe shiqim të vendngjarjes (sektorët kanë angazhuar 36 zyrtarë të tillë). Janë identifikuar disa raste kur zyrtarë të teknikës kriminalistike nuk kanë të kryer kursin përkatës (një në Prishtinë Qendër dhe një në Gjilan). Sektorët hetimor kanë edhe dhomat e dëshmimeve, por vetëm gjashtë (6) nga 18 zyrtarë të administrimit të dhomave të dëshmimeve, kanë kryer kurse mbi trajtimin e dëshmimeve dhe dhomave ku mbahen ato. IPK vlerëson se nivelet e ndjekjes së kursit bazik të hetimit të krimit dhe atij për menaxhimin e dhomave të dëshmimeve nuk janë të kënaqshme në shumicën e stacioneve dhe kjo mund të ndikojë edhe në efikasitetin dhe performancën në punë të sektorëve hetimor.

Rekomandimi nr. 1

IPK-ja u rekomandon Drejtorit të Departamentit për Operacione dhe Drejtorit të Departamentit të Burimeve Njerëzore që në koordinim me Divizionin e Trajnimit, drejtoritë rajonale (stacionet) të ndërmarrin veprimet e nevojshme që në kurset bazike të hetimit të krimit, si dhe trajtimin të dëshmimeve, të ketë përfshirje më të madhe të hetuesve nga sektorët hetimor të stacioneve policore.

3.2. Indikatorët e performancës në hetimin dhe zbulimin e krimit

3.2.1. Në vitin 2020 ka pasur një rënie për rreth 6.1% të numrit të veprave penale, të evidentuara nga stacionet policore në kuadër të drejtorive rajonale, krahasuar me një vit më parë. Në vitin 2019, numrin më të madh të krimeve e ka raportuar DRP- Prishtinë dhe Pejë, derisa në vitin 2020, numrin më të madh të tyre e ka raportuar DRP- Prishtinë dhe Prizren, ndër regjionet më të prekura nga krimi. Me gjithë rënien e numrit të krimeve në nivel regjionesh, jo të gjitha drejtoritë kanë raportuar rënie të numrit të rasteve penale. Katër drejtori kanë raportuar ngritje të numrit të rasteve për vitin 2020 (Gjakovë, Mitrovicë Jugu, Mitrovicë Veriu dhe Prizren). DRP- Gjakovë ka shënuar ngritjen më të madhe të numrit të rasteve për 14.2% krahasuar me vitin 2019. Gjithashtu, janë katër (4) drejtori, në zonat e përgjegjësisë së të cilave, trendi i krimit ka shënuar rënie, derisa rënien më të madhe e ka shënuar DRP-Pejë me 20.4%. Rënia e trendit të krimit ka ardhur edhe si rezultat i reduktimit të lëvizjeve të qytetarëve, ndikuar nga zbatimi i masave anti Covid. Ky trend pozitiv është inkurajues drejt përmbushjes së objektivit të përcaktuar me Planin Strategjik Zhvillimor, për “përmirësimin e ruajtjen e sigurisë publike, parandalimin dhe zbulimin e aktiviteteve kriminale”, në kuadër të të cilit janë paraparë aktivitete për zvogëlimin e rasteve kriminale dhe ngritjen e zbulueshmërisë.



3.2.2. Marrë parasysh numrin e krimeve për 1.000 banorë në nivel të zonave të përgjegjësive së drejtorive rajonale, në vitin 2019 kanë ndodhë 15 krime në 1.000 banorë, derisa në vitin 2020, kjo kuotë ka rënë në 14 krime në 1.000 banorë. Në vitin 2020, në kuadër të zonës së përgjegjësive që kontrollon DRP - Prishtinë, kanë ndodhur 19 krime në 1.000 banorë, derisa në kuadër të zonave të përgjegjësive së DRP- Prizren dhe Gjakovë kanë ndodhur 11 krime në 1.000 banorë. Në vitin 2019, raportit në mes të numrit të zyrtarëve të uniformuar në kuadër të regjioneve dhe numrit të krimeve ka qenë 1 me 6, derisa në vitin 2020 ka qenë 1 me 5.2 (në DRP-Prishtinë është 1 me 8.4 përkatësisht 1 me 6.7, kurse në kuadër të DRP - Mitrovicë Veriu është 1 me 1.1). Kjo statistikë duhet t'i shërbejë menaxhmentit ekzekutiv të Policisë së Kosovës, që me rastin e rishikimit funksional organizativ, të planifikojë një shpërndarje më adekuate të burimeve njerëzore, duke u bazuar edhe në nivelin e krimit në kuadër të zonave të përgjegjësive së drejtorive rajonale (stacioneve), meqë ka stacione që janë mbivlerësuar me burime njerëzore në raport me trendet e krimit. Mesatarja e përgjithshme e zbulueshmërisë së rasteve në nivel të të gjitha drejtorive në vitin 2019 ka qenë rreth 64%, derisa në vitin 2020 ka rënë në 60%. Më efektive në zbulimin e veprave penale ka qenë DRP - Pejë me 74%, përkatësisht 73%. Këta indikatorë tregojnë se DRP- Prishtina është regjioni me numrin më të madh të krimeve, me ngarkesën më të madhe të rasteve në raport me numrin e policëve dhe me numrin më të madh të rasteve për 1.000 banorë. Kjo drejtori rajonale ka performuar jo kënaqshëm dhe bashkë me DRP- Gjakovë kanë efikasitetin më të ulët në zbulimin e rasteve në dy vitet e fundit (për rastet e raportuara brenda viteve 2019 e 2020). Si duket këto dy drejtori kanë arritur të trajtojnë numër më të madh të lëndëve të viteve paraprahe, meqë të dhënat tregojnë se fokus i tyre ka qenë trajtimi me prioritet i rasteve, bartur nga vitet e kaluara (numri i rasteve të zbuluara nga kontigjenti i lëndëve të bartura dallon shumë me regjionet tjera dhe është më i lartë).

Tabela nr. 1 - Pasqyrë mbi trendet e krimit dhe nivelin e zbulueshmërisë së rasteve sipas zonave të përgjegjesisë së drejtorive rajonale policore (2019-2020)

Drejtoria Rajonale	Vepra penale 2019	Në 1.000 banor	Numri i krimeve për polic	% e zbul	Vepra penale 2020	Në 1.000 banor	Numri i krimeve për polic	% e zbul	+/- (2019 2020)
Ferizaj	3.243	18	7.2 (452)	66%	2.801	15	6.0 (470)	61%	-13.6
Gjakovë	2.026	10	5.4 (379)	50%	2.314	11	5.8 (402)	46%	+14.2
Gjilan	2.340	14	4.4 (537)	70%	2.069	12	3.7 (558)	68%	-11.6
Mitrovicë J.	2.073	11	4.5 (459)	68%	2.158	12	4.3 (497)	65%	+4.1
Mitrovicë V.	523	13	1.1 (495)	72%	536	14	1.1 (494)	73%	+2.5
Pejë	3.691	16	6.7 (554)	74%	2.937	13	5.1 (578)	73%	-20.4
Prishtinë	10.039	21	8.4 (1191)	57%	9.437	19	6.7 (1404)	52%	-6.0
Prizren	3.060	11	6.5 (471)	69%	3.091	11	6.4 (481)	71%	+1.0
Gjithsej	26.995	15	6.0 (4.538)	64%	25.353	14	5.2 (4884)	60%	-6.1

3.2.3. IPK ka analizuar trendin e zhvillimit e luftimit të krimit, zbulueshmërinë e veprave penale, efikasitetin e sektorëve hetimor, si dhe raportin ndërmjet rasteve të zbuluara kundrejt atyre të pa zbuluara. Në nivel të zonave të përgjegjesisë së 13 stacioneve të kategorisë A, ka pasur një rënie të numrit të krimeve në vitin 2020, për 2.5%, krahasuar me një vit më parë. Sa i përket numrit të krimeve, apo veprave penale të raportuara brenda zonave të përgjegjesisë së këtyre stacioneve, zona e përgjegjesisë e kontrolluar nga Stacioni Policor - Prishtinë Jugu mbetet një nga zonat më të prekura nga kriminaliteti përgjatë viteve 2019 - 2020. Më së paku e prekur nga krimi mbetet zona e kontrolluar nga Stacioni Policor-Leposaviq. Krahasimi i numrit të veprave penale të administruar nga stacionet, me numrin e rasteve të zbuluara nga ana e tyre, vë në pah se gjatë vitit 2020 është shënuar një trend negativ i përcjellur me rënie të zbulueshmërisë së rasteve për 4.1% krahasuar me vitin paraprak. Gjatë vitit 2019 janë zbuluar 57% e rasteve në nivel të kësaj kategorie stacionesh, kurse në vitin 2020, rreth 56% e rasteve të raportuar. Leposaviqi dhe Peja shquhen si stacionet me shkallën më të lartë të zbulueshmërisë gjatë vitit 2019 me 80%, përkatësisht 69%, derisa në vitin 2020, Leposaviqi dhe Mitrovicë Veriu me 80%, përkatësisht 76% të rasteve. Nëse vështrojmë edhe raportin ndërmjet numrit të rasteve të pazbuluar me ato të zbuluar, raport më pozitiv dhe inkurajues del të jetë ai i Leposaviqit me kuotat 1 me 3.9 për të dy vitet krahasimore (një rast i pazbuluar kundrejt 3.9 rasteve të zbuluara gjatë vitit). Kurse, një raport i tillë, por që del të jetë dekurajues është ai i shënuar në Gjakovë, Podujevë dhe Prishtinë Jugu. Te këto stacione, numri i rasteve të pa zbuluara është më i lartë se numri i rasteve të zbuluara përgjatë dy viteve (*shih tabelën 2*). Sektorët e hetimeve në kuadër të stacioneve policore në Leposaviq dhe Mitrovicë Veriu kanë burime më të mjaftueshme për të trajtuar më me komoditet rastet nën administrim, që janë më të pakta krahasuar me ato të stacioneve tjera policore, ku raporti ndërmjet numrit të rasteve dhe numrit të policëve është më i shpërputhshëm (hetuesit e stacioneve të tjera ngarkohen me numër më të madh rastesh).

Tabela nr. 2 - Trendet e krimit dhe zbulueshmëria sipas zonave të përgjegjesisë së stacioneve

Stacioni Policor	Numri i veprave penale (raste)		Raste të zbuluara		Përqindja e zbulueshmërisë		Raporti (pazbuluar/zbuluar)	
	2019	2020	2019	2020	2019	2020	2019	2020
Ferizaj	1.731	1.590	933	733	54%	46%	1:1.17	1:0.86
Gjakovë	1.094	1.228	427	392	39%	32%	1:0.64	1:0.47
Gjilan	1.153	1.094	738	662	64%	61%	1:1.78	1:1.53
Mitrovicë Jugu	656	798	424	506	65%	63%	1:1.83	1:1.73
Mitrovicë Veriu	209	237	140	179	67%	76%	1:2.03	1:3.09

Leposaviq	103	132	82	105	80%	80%	1:3.90	1:3.89
Pejë	2.050	1.564	1.410	1.063	69%	68%	1:2.20	1:2.12
Prishtinë Qendër	1.794	1.473	971	810	54%	55%	1:1.18	1:1.22
Prishtinë Jugu	2.106	2.193	1.014	944	48%	43%	1:0.93	1:0.76
Prishtinë Veriu	1.118	1.179	616	787	55%	67%	1:1.23	1:2.01
Podujevë	823	926	376	420	46%	45%	1:0.84	1:0.83
Fushë Kosovë	1.055	1.020	670	621	64%	61%	1:1.74	1:1.56
Prizren	1.478	1.554	926	1.145	63%	74%	1:1.68	1:2.80
Gjithsej	15.370	14.988	8.727	8.367	57%	56%	1:1.31	1:1.26

3.2.4. Është e njohur se burimet njerëzore janë pasuria më e madhe e më e kushtueshme e Policisë së Kosovës dhe varësisht nga madhësia dhe profesionalizmi i saj, varet dhe cilësia e shërbimit ndaj qytetarëve, në rastin konkret, luftimi i krimit brenda shoqërisë. Edhe pse janë brenda një kategorie, jo të gjitha stacionet policore kanë ngarkesa të njëjta me numër të rasteve. Nëse marrim parasysh mesatarën e përgjithshme të numrit të rasteve penale, në raport me numrin e zyrtarëve të sektorëve hetimor në nivel të 13 stacioneve policore të kësaj kategorie, del se gjatë dy viteve, një hetues ka administruar nga 62 deri në 64 raste penale. Duke u nisur nga ky këndvështrim, ka shumë sektorë hetimor që janë të ngarkuar me më pak, apo të mbingarkuar me raste, krahasuar me mesataren e derivuar. Marrim shembull Sektorin hetimor të Stacionit Policor në Fushë Kosovë, ku secili prej zyrtarëve të këtij sektori ka administruar nga 93 deri në 96 raste në vit, apo Stacioni Policor në Prizren, ku secili zyrtar i Sektorit hetimor ka administruar 82 deri në 86 raste në vit. Në anën tjetër, kemi shembull Sektorin hetimor në Stacionin Policor në Leposaviq, ku secili prej zyrtarëve të këtij sektori ka administruar 10 raste në vit, apo Stacioni Policor në Mitrovicë Veriu, ku secili zyrtar i Sektorit hetimor ka administruar 16 deri në 18 raste në vit. Efikasiteti i luftimit të krimit varet edhe nga kapacitetet e angazhuar në sektorë hetimor. Menaxhmenti ekzekutiv dhe drejtuesit tjerë policor duhet të analizojnë këtë fushë dhe të sigurohen se janë ndarë kapacitete të nevojshme, duke marrë parasysh ndjekjen e parimeve për ndarje të balancuar të burimeve njerëzore për çdo stacion, drejt luftimit efikas të krimit. Ndarja jo e duhur e kapaciteteve ndikon në cilësinë e shërbimeve, ndjekjen jo të duhur të krimit dhe demotivon hetuesit për shkak të ngarkesës së jashtëzakonshme me raste.

Tabela nr. 3 - Analizë mbi ngarkesën me raste penale dhe efektivitetin në zbulimin e veprave penale

Stacioni Policor	Numri i veprave penale (raste)		Numri i zyrtarëve në sektor	Ngarkesa e zyrtarëve policor me raste		Raporti (raste të zbuluar kundrejt të pazbuluar per hetues)	
	2019	2020		2019	2020	2019	2020
Ferizaj	1.731	1.590	21	82	76	44:38	35:41
Gjakovë	1.094	1.228	19	58	65	23:35	21:44
Gjilan	1.153	1.094	19	61	58	39:22	35:23
Mitrovicë Jugu	656	798	16	41	50	27:14	32:18
Mitrovicë Veriu	209	237	13	16	18	11:5	14:4
Leposaviq	103	132	10	10	13	8:2	10:3
Pejë	2.050	1.564	23	89	68	61:28	46:22
Prishtinë Qendër	1.794	1.473	26	69	57	37:32	31:26
Prishtinë Jugu	2.106	2.193	31	68	71	33:35	31:40
Prishtinë Veriu	1.118	1.179	20	56	59	31:25	40:19
Podujevë	823	926	12	69	77	32:37	35:42
Fushë Kosovë	1.055	1.020	11	96	93	61:35	57:36
Prizren	1.478	1.554	18	82	86	52:30	64:22

Rekomandimi nr. 2

IPK-ja i rekomandon Drejtorit të Departamentit për Operacione dhe Drejtorit të Departamentit për Burime Njerëzore, që në koordinim dhe bashkëpunim me Drejtorët Rajonal, të ndërmarrin veprime të nevojshme në kuadër të rishikimit funksional dhe organizativ, që stacionet policore të mund të sigurojnë kapacitete të mjaftueshme për hetimin dhe zbulimin e krimit, duke siguruar njëherit shpërndarje adekuate të burimeve, duke marrë parasysh dhe numrin e rasteve, apo nivelin e krimit në zonat e përgjegjësisë së stacioneve dhe drejtorive rajonale.

3.3. Aktivitetet policore në hetimin dhe zbulimin e krimit

3.3.1. Policia është një organ shtetëror që kujdeset për mbrojtjen e shoqërisë nga krimi, mbajtjen e rendit dhe qetësisë publike, si dhe sigurimin e rendit të caktuar shtetëror. Puna e Policisë në masë të madhe ka të bëjë me parandalimin, hetimin dhe zbulimin e krimit, prandaj ajo ndërmerr veprime hetimore dhe masa të nevojshme që të zbuloj veprat penale dhe kryesit e tyre, të mbledhë informata të nevojshme për vendndodhjen e kryesve të veprave penale, të zbulojë e ruajë gjurmët dhe provat tjera, që kontribuojnë në zbardhjen e kryesit të veprës penale dhe të mbledh informata të nevojshme për paraqitje në procedurë penale. Për t'u kundërvyer me sukses ndaj dukurive kriminale, Policia ndërmerr aktivitete të përcaktuara me ligjin në fuqi. Për të vlerësuar respektimin e rregullave dhe të procedurave gjatë menaxhimit të rasteve penale nga hetuesit dhe sektorët hetimor, janë siguruar një numër dosjesh penale, të cilat janë proceduar në Prokuroritë kompetente me kallëzime penale, apo me raporte të veçanta, me të cilat njoftohet Prokurori i Shtetit për veprën penale dhe kryesin e saj. Për të vlerësuar rregullësinë e lëndëve me dokumentet dhe formularët e nevojshëm që kanë të bëjnë me hetimin dhe dokumentimin e krimit, janë kontrolluar 130 lëndë penale. Nga secili stacion policor janë përzgjedhur nga dhjetë (10) lëndë dhe nga vlerësimi i tyre është konstatuar respektimi i disa prej veprimeve hetimore paraprake policore dhe përdorimi i formularëve unik nga hetuesit.

3.3.2. IPK-ja ka pasur fokus në të gjitha stacionet që të verifikojë nëse 130 mostrat e përzgjedhura janë evidentuar në Sistemin Informativ të Policisë së Kosovës (SIPK)¹. Gjatë këtij verifikimi është gjetur që jo në të gjitha rastet, informatat për personat e përfshirë në këto raste dhe informatat tjera të lidhura me to janë regjistruar saktë. Në 54 raste² nga gjithsej 130 raste të mostruara janë hasur situata ku personat e lidhur me rastet janë të regjistruara me të dhëna personale të ndryshme (jo të sakta) dhe të njëjtit nëse kërkohen në SIPK, dalin të jenë të regjistruar në më shumë se dy vende. Në të njëjtën kohë janë gjetur të regjistruar në Sistem, personat e lidhur me rastet penale, pa numër personal (në SIPK figurojnë vetëm me emër dhe mbiemër). IPK ka gjetur edhe kur personat janë të regjistruar me dy numra personal (pas verifikimit është parë që njëri nga numrat lidhet me ndonjë qytetar tjetër, që në sistem dhe në dosje penale, nuk figuron të jetë i përfshirë në rast³. Janë hasur raste kur të dhënat mbi kallëzimet penale të ushtruara nga Policia, të proceduara në Prokurorinë

¹SIPK është bazë e të dhënave operacionale për futjen dhe hulumtimin e informatave kriminale, rezultatet e vendimeve të gjykatave, prokurorisë, komunikacionit rrugor, si dhe rastet e hetuara, apo regjistruara nga Policia brenda territorit të Republikës së Kosovës, si dhe rezultatet tjera të siguruar nga organizatat tjera bashkëpunuese ndërkombëtare. Ky sistem është i përcaktuar që të sigurojë ruajtjen elektronike të të gjitha të dhënave lidhur me veprimet hetimore nga njësitë e hetimeve si dhe njësitë e tjera policore, të ruhen zinxhirët e ruajtjes së dëshmive të rasteve, për të cilat janë zhvilluar hetime, dhe të bëhet korrigjimi i rasteve gjatë periudhave të procedurës hetimore, sipas kërkesës për lëndët. Sistemi është në varësi nga përmbajtja, vendosja me kohë dhe korrekte si dhe azhurimi i informatave.

²Leposaviç (4/10), Prishtinë Qendër (5/10), Prishtinë Jugu (5/10), Fushë Kosovë (7/10), Pejë (5/10), Prishtinë Veriu (6/10), Mitrovicë Veriu (3/10), Gjakovë (1/10), Podujevë (4/10), Mitrovicë Jugu (4/10) dhe Prizren (6/10).

³Leposaviç (2019-SA-117).

kompetente, nuk kanë qenë të futura në SIPK⁴, personat e dyshuar të përfshirë në kallëzime penale nuk janë gjetur të regjistruar në këtë SIPK⁵, si dhe është hasur të jetë regjistruar numër më i madh i personave të dyshuar se sa që kanë qenë të përfshirë në rast penal (kallëzim penal)⁶. Në mostrat e përzgjedhura në Ferizaj e Gjilan nuk janë hasur parregullësi në mënyrën e regjistrimit/përpunimit të informatave në SIPK.

Rekomandimi nr. 3

IPK-ja u rekomandon përgjegjësve të bazës së të dhënave të Sistemit Informativ të Policisë së Kosovës (SIPK), që në të gjitha rastet e evidentimit të të dhënave kriminale mbi personat e lidhur me veprat penale, të jenë të kujdesshëm dhe të sigurohen se informatat regjistrohen saktë, duke u mbështetur në dokumente identifikimi të palëve.

3.3.3. IPK gjatë verifikimit të evidentimit në SIPK, të rasteve dhe personave të lidhur me veprat penale ka pasur kontakte me zyrtarë të SIPK-ut në nivelin lokal (stacionet). Lidhur me burimet njerëzore në kuadër të SIPK-ut, PSO - Sistemi Informativ i Policisë së Kosovës përcakton disa kriteret që duhet përmbushur zyrtarët e tillë. Sipas PSO-së, “për të ruajtur përmbajtjen dhe saktësinë e informatës në SIPK, për të siguruar mbajtjen, mbështetjen, zhvillimin, trajnimin, futjen e të dhënave, analizat dhe statistikën, strukturat organizative të mbështetjes së informatave do të mbulojnë nga tre nivele: niveli i stacionit/nënstacionit, drejtoritë rajonale dhe Drejtoria e Përgjithshme. Seleksionimi i personit bëhet përmes rekrutimit dhe çdo caktim në pozitë do të bëhet në bazë të rezultateve gjatë fazave të testimit dhe të ketë lejën e sigurisë apo sekrete”.⁷ IPK gjatë inspektimit ka vlerësuar nëse zyrtarët të cilët janë të caktuar të kryejnë detyra lidhur me futjen dhe trajtimin e të dhënave në SIPK janë të pajisur me lejen e sigurisë konfidenciale, apo sekrete dhe ka gjetur që jo në gjitha rastet punonjësit kanë qenë të pajisur me këto vendime të cilat i nxjerrë Agjencia e Kosovës për Inteligjencë me kërkesën e Policisë së Kosovës. Në Pejë, punonjësi në pozitën “zyrtar i bazës së të dhënave (SIPK)” i emëruar me vendimin për emërim në pozitë nr. 07/1-01A/6438), e ka të refuzuar lejen e sigurisë për nivelin konfidencial me vendimin e Agjencisë së Kosovës për Inteligjencë, nr. 06-200-2021, të datës 25.02.2021 dhe vazhdon të ushtrojë detyrën në kundërshtim me rregullat e përcaktuara nga Policia e Kosovës.

Rekomandimi nr. 4

IPK-ja u rekomandon drejtuesve të Policisë së Kosovës që në situata kur personave të verifikuar nga Agjencia e Kosovës për Inteligjencë u del rezultati negativ, të ndërmarrin hapat e nevojshëm sipas nenit 27 të Ligjit nr. 03/L-178 për Klasifikimin e Informacioneve dhe Verifikimin e Sigurisë, në drejtim të moscenueshmërisë së integritetit të informatave.

3.3.4. Nga momenti i marrjes së informatës për dyshimin për shkelje ligjore, Policia dokumenton mbi veprimet e saja deri në momentin e procedimit të rastit në organin kompetent. Bazuar në nenin 70, paragrafi 5 i KPP-së, pas pranimit të informatës për veprën penale të dyshuar, Policia heton nëse ka dyshim të arsyeshëm që një vepër penale që ndiqet sipas detyrës zyrtare, të jetë kryer. Policia është e detyruar që brenda 24 orëve t’i dorëzojë një raport policor Prokurorit të Shtetit që është kompetent, i cili pastaj vendosë nëse duhet filluar procedurën penale. Lidhur me këtë, është

⁴ Prishtinë Jugu (2019-AD-2937), Prishtinë Veriu (2019-AC-0297, 2019-AC-0902 dhe 2019-AC-0779).

⁵ Prishtinë Veriu (2019-AC0902), Podujevë (2019-AF-408).

⁶ Prizren (2019-GA-0905).

⁷ PSO- Sistemi Informativ i Policisë së Kosovës, me nr. referues ZDPO-02/020/14, e datës 27.11.2014.

verifikuar prezenca e raportit policor brenda dosjes penale, ku është parë që në asnjë rast nuk është përmbushur ky kriter. Të gjitha 130 dosjet hetimore të kontrolluar, nuk kanë pasur raporte policore njoftuese për Prokurorin, të proceduar nga sektorët hetimor në prokuroritë kompetente. Mungesa e raporteve vjen nga neglizhenca e zyrtarëve policor të sektorëve hetimor të stacioneve për të hartuar raporte me përshkrimin e dyshimit të arsyeshëm lidhur me veprën penale, për të cilën janë në dijeni. Mosraportimi me shkrim i dyshimit të arsyeshëm mbi veprën penale është mosrespektim i nenit 70, paragrafi 5 të KPP-së. IPK-ja edhe më parë në inspektimet e zhvilluara në disa nivele të organizimit policor ka evidentuar rrethana të tilla të mosrespektimit të këtij neni, me ç'rast edhe i ka rekomanduar Policisë së Kosovës që të sigurohet, që në rrethanat kur vie deri tek “dyshimi i arsyeshëm” se është kryer një vepër penale, brenda 24 orëve të respektohet dispozita ligjore nga KPP, për t’i dorëzuar raportin policor njoftues, Prokurorit kompetent të Shtetit.

Rekomandimi nr. 5

IPK-ja u rekomandon Shefave të Sektorëve Hetimor të stacioneve, që të ushtrojnë kontroll më strikt në përmbushjen e obligimeve që dalin nga neni 70, paragrafi 5 i KPP-së, sipas së cilës dispozitë, Policia posa të ketë dyshim të arsyeshëm se është kryer vepër penale, brenda 24 orësh t’i dërgoj raport Prokurorit kompetent të Shtetit, i cili më pas vendosë nëse duhet filluar procedura penale lidhur me rastin.

3.3.5. Policia ka të drejtë të marrë në pyetje personat që mund të jenë dëshmitarë të një vepre penale, si dhe të dyshuar për kryerjen e veprës penale, të cilët paraprakisht duhet t’i informojë për të drejtat që u takojnë atyre gjatë marrjes në pyetje dhe për këtë përpilon raport të marrjes në pyetje. Gjatë ushtrimit të autorizimeve që rrjedhin si rezultat i përgjegjësive dhe detyrave të parapara me ligj, Policia luan rol të rëndësishëm në mbrojtjen dhe respektimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut. Bazuar në nenin 125 të KPP-së, në fillim të marrjes në pyetje në procedurën paraprake, hetuesi i autorizuar nga Prokurori i Shtetit, i lexon dëshmitarit, apo të dyshuarit, paralajmërimet mbi të drejtat e rezervuara nga ky Ligj, dhe i njëjti duhet të konfirmojë me shkrim mbi të kuptuarit e të drejtave nga palët. IPK-ja ka vlerësuar respektimin e këtyre të drejtave në procedurë paraprake, gjatë marrjes në pyetje të të dyshuarve dhe dëshmitarëve. Nga 130 dosje të kontrolluara, në 14 prej tyre⁸, janë gjetur deklaratat që nuk i përmbajnë të drejtat e rezervuara të të dyshuarve, gjegjësisht të dëshmitarëve. Në disa deklaratat që i përmbajnë të drejtat e palëve, ato nuk janë konform neneve të parapara në KPP. Po ashtu, është hasur në deklaratat që nuk janë nënshkruar nga marrësit e tyre. Në disa dosje, ka raste kur procesverbalet e marrjes në pyetje (deklaratat) nuk janë të nënshkruara as nga personat e dyshuar, apo dëshmitarët e intervistuar. Neglizhenca e hetuesve në rastet e tilla mund të sjellë efekte negative gjatë zhvillimit të fazave të mëvonshme të procedurës penale. IPK nxitë shtimin e kontrolleve nga Shefat e sektorëve në drejtim të eliminimit të këtyre dobësive.

Rekomandimi nr. 6

IPK-ja u rekomandon zyrtarëve policor të sektorëve të hetimeve të stacioneve policore, që me rastin e marrjes në pyetje, dëshmitarëve apo të dyshuarve t’iu lexohen paralajmërimet mbi të drejtat e tyre, konform dispozitave ligjore të Kodit të Procedurës Penale, dhe në fund të marrjes në pyetje, procesverbalet të mos procedohen pa nënshkrimin e palëve.

⁸ Pejë (5 nga 10 dosje), Ferizaj (1/10) dhe Gjilan (8/10).

3.3.6. Gjatë analizimit të 130 dosjeve hetimore është vërejtur se jo në të gjitha rastet, formularët e përdorur brenda dosjeve hetimore (procesverbalet e marrjes në pyetje, kallëzimet penale, raportet e veçanta dhe shkresa të tjera), janë unik në kuadër të sektorëve hetimor të stacioneve policore. Vërehet që nuk ka një standard të hartimit të shkresave në të gjithë sektorët hetimor të stacioneve policore. Mosaplikimi i formave unike brenda dosjeve kuptohet më tepër si neglizhencë e hetuesve në përdorimin e tyre. Andaj, sektorët hetimor duhet të mobilizohen në përdorimin e standardizuar të shkresave të tilla operationale. Tashmë formularët e tillë janë të qasshëm dhe hetuesit mund t'i sigurojnë përmes intranetit. IPK inkurajon Shefat e Sektorëve të hetimeve në stacione policore që të shtojnë kontrollin në mënyrë që gjatë kryerjes së veprimeve hetimore, të aplikohen formularët dhe shkresat unike, të harmonizuara me dispozitat ligjore në fuqi, me qëllim të krijimit të dosjeve të standardizuara hetimore.

3.3.7. IPK gjatë kontrollimit të dosjeve ka vlerësuar përfshirjen e “Pakos informuese për viktimat e krimit”, e cila ka filluar të zbatohet nga viti 2019. Pako përmban kartelën e viktimës me informata dhe këshilla mbi rastin dhe e njëjta është obligative që të jetë e përfshirë si pjesë e dosjes penale. Gjatë kontrollit të lëndëve penale është gjetur se në 98 raste⁹ nuk është përfshirë Pako informuese për viktimat, si pjesë e dosjes, derisa 32 dosje tjera kanë pasur të bashkëngjitur Paketën e tilla. Këto lëshime konsiderohet se janë rezultat i neglizhencës dhe seriozitetit jo të duhur së hetuesve. IPK-ja inkurajon shefat e sektorëve hetimor që të aplikojnë kontrollin më të rreptë mbi hetuesit e rasteve, në mënyrë që në secilin rast dhe secilën viktimitë të lidhur me rastin, t'i ofrohet Pako informuese me qëllim që të kenë mundësinë të informohen mbi rastin dhe rrjedhën e tij në vazhdimësi.

3.3.8. Nga kontrolli i dosjeve penale vërehet se kallëzimet penale përmbajnë elementet kyçe të përshkrimit të veprës penale të dyshuar, duke paraqitur provat e zbuluara në procesin e mbledhjes së të dhënave. IPK-ja ka matur edhe azhuritetin e sektorëve hetimor në trajtimin e rasteve hetimore dhe kohën e procedimit të kallëzimeve në prokuroritë kompetente, duke pasur në dispozicion 120 mostra të dosjeve penale. Është nxjerrë koha mesatare për të gjitha stacionet policore të kategorisë A dhe ndaras për secilën veç e veç. Përgjithësisht një kallëzim penal është përgatitur (dorëzuar) për 37 ditë kalendarike, duke marrë në konsideratë periudhën nga momenti i raportimit deri në momentin e dorëzimit në Prokurorinë kompetente. Nëse krahasojmë performancën e secilit stacion veç e veç, vërejmë se sektorët hetimor të stacioneve policore në Pejë, Gjakovë, Mitrovicë Veriu dhe Prizren kanë qenë më ekspeditiv në procedimin e kallëzimeve penale, me një mesatare të procedimit të lëndëve prej 15, 25, 25 dhe 27 ditësh për rast.

3.3.9. IPK është interesuar të dijë nëse secila dosje penale ka të dokumentuar në dosje, të kaluarën kriminale të personave të dyshuar dhe nëse personat e njëjtë janë përsëritës të veprave penale. Ky inspektim vë në pah se në 72 nga gjithsej 130 dosje të kontrolluara¹⁰ është përfillur ky element për të dokumentuar në dosje, të kaluarën kriminale të personave të dyshuar (55%). Në këtë drejtim, Policia ka bërë punë të mirë dhe shumicës së dosjeve të kontrolluara iu janë bashkëngjitur dëshmitë

⁹ Gjakovë (9/10), Prishtinë Qendër (4/10), Mitrovicë Jugu (5/10), Gjilan (10/10), Podujevë (7/10), Prishtinë Veriu (10/10), Prizren (9/10), Fushë Kosovë (7/10), Ferizaj (10/10), Pejë (5/10), Mitrovicë Veriu (10/10), Leposaviq (4/10) dhe Prishtinë Jugu (8/10).

¹⁰ Në Prishtinë Jugu në 8(10) raste, në Pejë në 1(10) rast, në Ferizaj në 3(10) raste, në Fushë Kosovë në 6(10) raste, në Prizren në 5(10) raste, në Prishtinë Veri në 6(10) raste, në Podujevë në 10(10) raste, në Gjilan në 3(10) raste, në Mitrovicë Jugu në 6(10) raste, në Prishtinë Qendër në 7(10) raste, në Gjakovë në 4(10) raste, në Mitrovicë Veri në 4(10) raste dhe në Leposaviq në 9(10) rasteve të inspektuara.

mbi të kaluarën kriminale të kryesve të dhunës në familje. IPK-ja inkurajon Policinë që edhe më tutje të sigurojë të dhënat për të kaluarën kriminale, të secilit person të dyshuar, ngase kjo do të ndihmojë organet gjyqësore kur të marrin vendime mbi rastet konkrete.

3.3.10. Hetuesit policor që trajtojnë raste penale në kuadër të stacioneve policore, në bashkëpunim të ngushtë me udhëheqësin e njësisë duhet ta bëjnë përpjekje që hetimi i rastit të bëhet në një afat sa më të shkurtër dhe të arsyeshëm dhe duke qenë në koordinim të ngushtë me Prokurorin e Shtetit. Deri te momenti i procedimit të rastit në Prokurorinë kompetente, hetuesi me rastin e kompletimit të hetimit duhet të dërgojë lëndën për kontrollë dhe nënshkrim tek mbikëqyrësi i vijës së parë në Sektorin e Hetimeve dhe përmes tij, tek Shefi i hetimeve. Lënda nuk dërgohet në Prokurori pa nënshkrim të Shefit të hetimeve, apo Zëvendësit të tij, përveç rasteve urgjente kur ka të arrestuar¹¹. Në 16 raste¹², lëndët janë proceduar në Prokurori, nënshkruar vetëm nga hetuesit e lëndëve. Në 73 raste tjera¹³, lëndët janë proceduar, nënshkruar nga hetuesit e lëndëve dhe mbikëqyrësit e vijës së parë. Në 39 raste¹⁴, lëndët janë nënshkruar nga hetuesit e lëndëve, mbikëqyrësit e vijës së parë në sektorin e hetimeve, si dhe shefat e sektorëve të hetimeve, ashtu siç parashihet në PSO-në mbi kompetencën lëndore. Në dy (2) raste¹⁵ janë gjetur lëndë të aprovuara edhe nga Komandanti i Stacionit Policor, të aprovuara (kontrolluara) në katër nivele. Nga kontrolli i dosjeve vëhet në pah se në 89 nga 130 dosje penale nuk është respektuar zinxhiri komandues që dosjet t'i nënshtrohen filtrave të kontrollit dhe të nënshkruhen nga mbikëqyrësit e njësive, për t'u vlerësuar nëse rastet janë kompletuar në bazë të procedurave të parapara dhe në pajtim me ligjet në fuqi, për të shmangë mungesat e veprimeve, që mund të shpiejnë në zbardhjen e fakteve dhe rrethanave për vënien para drejtësisë së kryesve të veprave penale. Kurse, në dy raste kontrolli i ushtruar ndaj lëndëve ka qenë më rigoroz duke tejkalar edhe rregullat e përcaktuara në PSO. Dobësitë e tilla të identifikuar nga kontrolli i dosjeve janë rezultat i neglizhencës dhe seriozitetit jo të duhur të hetuesve dhe drejtuesve të sektorëve hetimor me rastin e procedimit të rasteve.

Rekomandimi nr. 7

IPK-ja u rekomandon Shefave të Sektorëve të Hetimeve në kuadër të stacioneve policore, që pas kryerjes së veprimeve hetimore dhe kompletimit të procesit të hetimit, dosjet para dorëzimit në Prokuroritë kompetente t'i nënshtrohen kontrollit dhe më pas të nënshkruhen nga mbikëqyrësit e vijës së parë dhe përmes tyre, nga shefat e njësive hetimore, apo zëvendësit e tyre.

3.3.11. Hetuesit policor përpilojnë kallëzime penale, ku paraqiten provat e zbuluara në procesin e mbledhjes së të dhënave dhe dorëzohet së bashku me sendet, skicat, fotografitë, raportet e marra, procesverbalet e masave dhe veprimeve të kryera, shënimet zyrtare, deklaratimet e marra dhe materiale tjera, të cilat mund të kontribuojnë në zbatimin efektiv të procedurës¹⁶. Pas përfundimit të hetimit, ose kur prokurori i shtetit konsideron se informacionet, me të cilat disponon për veprën penale dhe kryesin e saj paraqesin dyshim të bazuar mirë se i pandehuri ka kryer vepër penale apo

¹¹ PSO - Procedimi i lëndëve dhe kompetencat lëndore të hetimit, kapitulli VI, pika 6.

¹² Pejë (1 nga 10), Gjilan (1/10), Prishtinë Qendër (3/10), Mitrovicë Jugu (10/10) dhe Prizren (1/10).

¹³ Prishtinë Qendër (2/10), Podujevë (10/10), Gjilan (9/10), Gjakovë (4/10), Prishtinë Veriu (2/10), Prishtinë Jugu (10/10), Pejë (5/10), Prizren (2/10), Fushë Kosovë (10/10), Mitrovicë Veriu (9/10) dhe Ferizaj (10/10).

¹⁴ Prizren (5/10), Prishtinë Veriu (8/10), Pejë (4/10), Gjakovë (6/10), Leposaviq (10/10), Mitrovicë Veriu (1/9) dhe Prishtinë Qendër (5/10).

¹⁵ Prizren (2/10).

¹⁶ Kodi nr. 04/L-123 i Procedurës Penale të Republikës së Kosovës.

vepra penale, procedura para gjyqit mund të zbatohet vetëm në bazë të aktakuzës së ngritur nga Prokurori i Shtetit. Po ashtu, Prokurori i Shtetit me aktvendim e hudhë kallëzimin penal të pranuar nga Policia apo burime tjera brenda tridhjetë (30) ditëve në rastet kur plotësohen kushtet e parapara me ligj¹⁷. Bashkëpunimi dhe bashkërendimi i mirë mes Policisë dhe Prokurorisë shihet si parakushti kryesor për hetimin e ndjekjen e suksesshme penale, duke mundësuar llogaridhënien e përbashkët dhe krijimin e vlerave dhe qëllimeve të përbashkëta. Bazuar në këtë, IPK duke pasur si mostër 130 dosje penale, të proceduara në Prokuroritë kompetente¹⁸, ka synuar të dijë epilogun e tyre në kohën e inspektimit. Zyrtarët policor në 130 raste kanë siguruar informatat lidhur me epilogun e këtyre rasteve dhe është parë se Prokuroria bazuar në hetimet e zhvilluara nga Policia, në 76 raste¹⁹ ka ngritur aktakuza (58%) dhe në 16 raste ka hudhur kallëzimet penale apo ka pushuar hetimet (12%)²⁰. Pastaj 19 raste të tjera²¹ janë ende në procedurë hetimore (15%) dhe 19 raste²² janë të përfunduara me aktgjykime (15%).

3.4. Trajtimi i dëshmive

3.4.1. Kodi nr. 04/L-123 i Procedurës Penale dhe Procedura Standarde e Operimit mbi Dhomat e dëshmive (ref. ZDPO-02/008/14) janë dokumentet bazike që përcaktojnë detyrat dhe autorizimet policore për trajtimin e dëshmive, që nga sekuestrimi apo konfiskimi i tyre, deri te procedimi final i tyre. KPP parasheh që “sendet dhe pasuria e sekuestruar përkohësisht janë nën mbikëqyrje të Prokurorit të Shtetit. Prokurori i Shtetit mund t’ia delegojë mbikëqyrjen dhe kontrollin, zyrtarit të autorizuar të Policisë për sendet dhe pasurinë e sekuestruar përkohësisht”²³. Sipas Kodit, mes tjerash “Policia është autorizuar të zbulojë, mbledhë dhe ruajë gjurmët dhe provat nga vendi i ngjarjes për veprën penale të dyshuar dhe të urdhërojë testimin mjeko-ligjor të atyre provave nga laboratorit i mjekësisë ligjore”²⁴. PSO përcakton rregulla standarde të trajtimit dhe menaxhimit të sendeve, pasurive, provave dhe parave të konfiskuara si dhe vendosjes, sistemimit dhe ruajtjes së tyre në dhomat e dëshmive. Njësitë policore që merren me trajtimin e dëshmive janë përcaktuar me Strukturën organizative të Policisë. Në nivel lokal funksionojnë dhomat e dëshmive²⁵ në kuadër të drejtorive rajonale dhe stacioneve policore. IPK-ja ka vlerësuar kryerjen e detyrave në trajtimin e dëshmive dhe kushtet nën të cilat ruhen ato (siguria, akomodimi, sistemimi, paketimi, ruajtja dhe evidentimi). Janë inspektuar 130 dëshmi që lidhen me rastet e mostruara, në 13 dhoma të dëshmive të stacioneve policore (nga 10 dëshmi për secilin stacion).

¹⁷ Kodi i Procedurës Penale të Republikës së Kosovës, neni 82 (Hudhja e kallëzimit penal të policisë).

¹⁸ 120 dosjet kanë përfshirë nga pesë (5) dosje të stacioneve lidhur me dhunën në familje, nga grupi i veprave kundër martesës dhe familjes (kapitulli XXI i KPP-së), nga dy (2) dosje lidhur me vjedhjet nga grupi i veprave kundër pasurisë (kapitulli XXVI) dhe nga tre dosje lidhur me mbajtjen në pronësi, kontroll apo posedim të paautorizuar të armëve nga grupi i veprave të paraparë në kapitullin XXIX (të gjitha janë lëndë me kryes të njohur, të marra në secilin stacion policor të kategorisë A).

¹⁹ Prizren (9/10), Prishtinë Veriu (8/10), Ferizaj (10/10), Gjilan (8/10), Prishtinë Jugu (8/10), Mitrovicë Jugu (7/10), Prishtinë Qendër (3/10), Podujevë (5/10), Fushë Kosovë (9/10), Leposaviq (4/10) dhe Mitrovicë Veriu (5/10).

²⁰ Gjakovë (1/10), Prishtinë Veriu (1/10), Prizren (1/10), Prishtinë Qendër (3/10), Podujevë (3/10), Fushë Kosovë (1/10), Leposaviq (1/10), Pejë (4/10) dhe Mitrovicë Veriu (1/10).

²¹ Gjakovë (2/10), Prishtinë Veriu (1/10), Prishtinë Jugu (2/10), Mitrovicë Jugu (3/10), Podujevë (1/10), Leposaviq (3/10), Pejë (3/10) dhe Mitrovicë Veriu (4/10).

²² Gjakovë (7/10), Gjilan (2/10), Prishtinë Qendër (4/10), Podujevë (1/10), Pejë (3/10) dhe Leposaviq (2/10).

²³ Kuvendi i Republikës së Kosovës, *Kodi i Procedurës Penale*, neni 112 (Sekuestrimi i përkohshëm), paragrafi 9.

²⁴ Kuvendi i Republikës së Kosovës, *Kodi i Procedurës Penale*, neni 70 (Veprimet hetimore të Policisë), paragrafi 3.

²⁵ Dhoma për ruajtjen e sendeve, pasurisë, provave apo parave të gjetura është dhomë e caktuar dhe e siguruar mirë ku vendosen, trajtohen dhe ruhen sendet, pasuria apo paratë e gjetura, të falsifikuara apo të sekuestruara, të cilat janë nën administrimin e njësisë hetimore të stacioneve policore, drejtorive rajonale policore dhe në nivel qendror.

3.4.2. Për të parandaluar humbjen, dëmtimin, shkatërrimin, kalbjen apo kontaminimin, dëshmitë duhet trajtuar me kujdes. IPK-ja ka gjetur që disa nga dhomat e dëshmimeve nuk kanë përmbushur kriteret e përcaktuara me PSO. Janë gjetur dëshmi, të cilat nuk ruhen të ndara në vende të posaçme, varësisht prej specifikave të tyre. Pesë (5) dëshmi të mostruara në Gjilan²⁶ nuk ruhen të ndara varësisht nga specifikat e tyre. Situatë e njëjtë është hasur dhe me katër (4) raste në Prishtinë Jugu²⁷ dhe në dy (2) raste në Mitrovicë Veriu dhe Leposaviç²⁸. Në Ferizaj, paratë e konfiskuara që janë dorëzuar për ruajtje në dhomën e dëshmimeve, nuk janë gjetur brenda zonës së deponimit dhe mbahen në një sef në zyrën e zyrtarit përgjegjës të dhomës së dëshmimeve në katin më lartë të objektit ku është e vendosur dhoma e dëshmimeve. Kjo hapësirë ndahet edhe me zyrtarë tjerë policor. Mbajtja e parave të konfiskuara jashtë dhomës së dëshmimeve, ku qasja e personelit tjetër policor nuk është e kufizuar, vlerësohet si ruajtje/trajtim joadekuat i dëshmimeve dhe në kundërshtim me kapitullin V, pika C, paragrafi 1 të PSO-së, duke cenuar dhe rrezikuar kështu nivelin e sigurisë së tyre.

Rekomandimi nr. 8

IPK-ja u rekomandon zyrtarëve përgjegjës të dhomës së dëshmimeve në Stacionin Policor në Ferizaj që të gjitha dëshmitë dhe sendet e konfiskuara të ruhen brenda hapësirave të dhomës së dëshmimeve, po ashtu bankënotat dhe gjërat e çmuara të deponohen në sef, apo arkë metali brenda zonës së deponimit të sendeve dhe dëshmimeve.

3.4.3. Jo të gjitha dëshmitë duhet ruajtur brenda dhomës së deponimit të dëshmimeve. Bazuar në kapitullin V, pika C, nën pikat 3 dhe 4 të PSO-së, sendet dhe dëshmitë e rrezikshme (eksplozivët, materiet radio - aktive, mjetet zjarrvënëse, materialet helmuese apo ndonjë materie kimike tjetër të natyrës së dëmshme) nuk guxojnë të deponohen në Dhomën e dëshmimeve. Zyrtari përgjegjës i Dhomës së dëshmimeve duhet menjëherë të kërkojë transferimin e tyre në lokacionet e destinuara për to. Në Dhomën e dëshmimeve në Stacionin Policor - Prishtinë Veriu është i deponuar serveri i këtij stacioni. Serveri është funksional dhe stafi policor është në dijeni që prezenca e një pajisjeje të këtij lloji paraqet rrezik për dëshmitë e deponuara brenda kësaj hapësire.

3.4.4. Që të mos ketë ndërhyrje, ndryshim, rrezikim a humbje gjatë deponimit, duhet të përdoret shirit për bllobmë të paketimit. IPK-ja ka përzgjedhur dëshmi në baza rastësore nga Regjistri i dëshmimeve dhe ka inspektuar nëse ato janë të mbyllura me shirit bllobmues. Nga ky verifikim është hasur se në 43 raste dëshmitë nuk kanë pasur shirit bllobmues²⁹. IPK-ja vlerëson se hetuesit që dorëzojnë dëshmitë dhe zyrtarët përgjegjës që i pranojnë ato në dhomat e dëshmimeve duhet të kenë kujdes që të përmbushin detyrat konform kriterëve lidhur me trajtimin e dëshmimeve, në drejtim të ngritjes së integritetit të dëshmimeve. Në asnjë dhomë të dëshmimeve të stacioneve nuk janë hasur raste të hapjes së dëshmimeve, për të cilat është bërë regjistrimi special. Paketimi i sendit, pasurisë, provës apo parasë së gjetur/konfiskuar duhet të bëhet sipas llojit të dëshmisë, kushtet e dëshmimeve dhe ekzaminimit që duhet të kryhet në laborator. IPK ka gjetur që disa nga dhomat e dëshmimeve nuk kanë përmbushur këtë kriter. Nga inspektimi i realizuar është hasur që 26 dëshmi të ekzaminuara në dhomat e dëshmimeve të 10 stacioneve policore nuk kanë qenë të paketuara ne paketim adekuat³⁰.

²⁶ 029/2021, 026/2021, 041/2017, 043/2019 dhe 047/2018.

²⁷ 042/20, 015/20, 102/19, 093/20 dhe 093/20.

²⁸ G-18 dhe 004/2017.

²⁹ Gjilan (6/10), Ferizaj (4/10), Gjakovë (9/10), Prizren (5/10), Mitrovicë Veriu (1/10), Prishtinë Qendër (1/10), Prishtinë Veriu (6/10), Prishtinë Jugu (1/10), Podujevë (5/10) dhe Fushë Kosovë (5/10).

³⁰ Gjilan (5/10), Podujevë (5/10), Prishtinë Veriu (5/10), Ferizaj (2/10), Gjakovë (4/10), Prizren (1/10), Mitrovicë Veriu (1/10), Leposaviç (1/10), Prishtinë Qendra (1/10) dhe Fushë Kosovë (1/10),

Rekomandimi nr. 9

IPK-ja u rekomandon zyrtarëve përgjegjës të dhomave të dëshmime në kuadër të stacioneve policore, që me rastin e pranimit të dëshmime nga hetuesit e rasteve, të sigurohen se dëshmitë janë të mbyllura dhe të paketuara në paketime adekuate, dhe të njëjtat të ruhen në vende të posaçme, varësisht nga specifikat e tyre me qëllim të ruajtjes nga dëmtimet e mundshme.

3.4.5. Në Dhomën e dëshmime ruhen sendet, pasuria provat apo paratë e gjetura, të falsifikuara apo të sekuestruara, të cilat janë nën administrimin e njësisve të hetimeve të stacioneve policore. IPK ka hasur në disa stacione policore që në Dhomat e dëshmime të tyre mbajnë gjëra që nuk janë sekuestruar/konfiskuar si rezultat i konfiskimit, konform Kodit të Procedurës Penale, gjërat e tilla nuk gjenden të regjistruara as në libër fizik apo databazën elektronike. Në Dhomën e dëshmime të Stacionit Policor - Prishtinë Qendër, gjendet një sef metali i administratës së Stacionit, në Prishtinë Veriu mbahen armë të personave që kanë aplikuar për leje për armë Në Prishtinë Jugu mbahet një armë zyrtare Glock 19 (arma e një zyrtari nga sektori i hetimeve qëndron në dhomë deri në kthimin e tij nga udhëtimi jashtë vendit). Në Stacionin Policor në Fushë Kosovë mbahen armë që më parë ishin me leje, por që tani iu ka skaduar afati i lejes, apo edhe që pronari i armës më leje ka vdekur, ndërsa pasardhësit e tij e kanë dorëzuar armën në stacion policor.

Rekomandimi nr. 10

IPK-ja u rekomandon zyrtarëve përgjegjës të dhomave të dëshmime në kuadër të stacioneve policore (Prishtinë Qendër, Prishtinë Veriu, Prishtinë Jugu dhe Fushë Kosovë), që në asnjë rast të mos pranojnë dhe mbajnë sende, që nuk janë të sekuestruara/konfiskuara konform dispozitave të Kodit të Procedurës Penale.

3.4.6. Me rastin e dorëzimit të dëshmisë, Lista e dëshmime dhe Zinxhiri i ruajtjes duhet plotësuar në mënyrë të duhur duke përmbajtur informatat që përshkruajnë dëshmitë, të dhënat e personit që e ka gjetur - dorëzuar, apo konfiskuar, datën dhe kohën. Informatat mbi dëshmitë duhet të jenë të dokumentuara në regjistrin e dëshmisë dhe të përmbajë të dhënat mbi kohën e pranimit-dorëzimit, njësinë hetuese, numrin e rastit, llojin e veprës penale, informatat për policin që dorëzon-pranon dëshminë, përshkrimin e çdo mjeti, përfshirë numrin e mjetit, numrin serik, shenjën klasifikuese, etj. Pas regjistrimit në Regjistër, informata në mënyrë ekuivalente transferohet në databazë. Çdo lëvizje e sendit apo dëshmisë, të dorëzuar në gjykatë apo njësi tjetër, që i është kthyer pronarit apo personit të autorizuar, regjistrohet në Regjistër dhe në bazën e të dhënave. Në rast se sendi dhe dëshmia është dorëzuar për ekzaminim/analiza në laboratorin kriminalistik, kjo lëvizje regjistrohet në Regjistër të dëshmime dhe databazë. Në rast kur dëshmitë me urdhëresë kërkohen nga Gjykata - Prokuroria, dorëzohen për ekzaminim/analiza apo ri-ekzaminim në laborator, kjo regjistrohet në Regjistër dhe databazë, dhe për të njëjtën duhet të bashkangjitet kopja e raportit të ekzaminimit, e cila duhet të ruhet në dosjet e dhomës së dëshmime. Për të vërtetuar rregullësinë e evidencave është verifikuar nëse janë bërë regjistrimet në mënyrë ekuivalente në to. Të gjitha dhomat e dëshmime mbajnë regjistrat fizikë të dëshmime dhe databazat elektronike. Por janë hasur disa parregullësi në regjistrimin e dëshmime në këto dy lloj regjistrash. Në Gjakovë, Mitrovicë Jugu e Mitrovicë Veriu janë identifikuar raste kur dëshmitë nuk janë regjistruar në databaza³¹. Në Gjilan dhe Mitrovicë Veriu janë gjetur mospërputhje të dhënash në mes të Regjistrit dhe Zinxhirit të ruajtjes³².

³¹ Dëshmitë e rasteve me nr. 2021-EA-0075, 2020-EA-0547, 2019-EA-1446, 2021-EA-652 (Gjakovë); 2020-BC-951, 2020-BC-887, 2020-BC-892, 2020-BC-882 (Mitrovicë Jugu) dhe 2019-SA-189 (Mitrovicë Veriu).

³² Dëshmitë e rasteve me nr. 2021-CA-0433 dhe CA-17-756 (Gjilan); 2019-SA-252 (Mitrovicë Veriu).

3.4.7. Zinxhiri i ruajtjes së sendit, pasurisë, provës apo parasë së gjetur është dokument apo formular i domosdoshëm që evidenton - prezenton konfiskimin, pranim-dorëzimin, ekzaminimin, lëvizjet, vendosjen dhe ruajtjen e sendeve dhe dëshmimeve, si dhe prezencën apo qasjen e zyrtarëve policor. Originali i formës së "Zinxhirit të ruajtjes" duhet të mbetet në Dhomën e dëshmimeve së bashku me sendin/dëshminë, ndërsa kopja, në dosjen e dëshmisë. Gjatë inspektimit në dhomat e dëshmimeve në Gjakovë dhe Fushë Kosovë janë identifikuar dy (2) raste kur nuk janë prezentuar zinxhirët e ruajtjes për dëshmitë e deponuara³³. Në Dhomat e dëshmimeve në Mitrovicë Veriu e Fushë Kosovë janë vërejtur mospërputhje në mes të numrit të dëshmimeve fizike me informatat në Regjistrin e dëshmimeve, zinxhirin e ruajtjes dhe listën e dëshmimeve³⁴.

3.4.8. Evidenca për sistemimin, emërtimin e raftit e lokacionin e dëshmisë duhet mbajtur Zyrtari përgjegjës i dhomës së dëshmimeve, i cili duhet të jetë në gjendje për të identifikuar dhe dokumentuar lokacionin e çdo dëshmie të deponuar, e që është një hap me rëndësi në funksion të ruajtjes dhe prezantimit të shpejtë të tyre. Lidhur me këtë, të gjitha kutitë e metalta, raftet dhe kabinetet duhet të kenë adresë të qartë lexuese. Kjo garanton se i gjithë lokacioni është i shënjuar - evidentuar në mënyrë të duhur, duke shfrytëzuar sistemin numerik të organizuar që është specifik si element i vlefshëm i sistemit³⁵. Jo të gjitha dhomat kanë të rregulluar evidencat mbi sistem të tillë numrash. Dhomat e dëshmimeve në Gjilan dhe Fushë Kosovë nuk kanë plotësuar këtë kriter. Zyrtarët përgjegjës të Dhomave të dëshmimeve në Gjilan dhe Gjakovë nuk kanë qenë të gjendje të lokalizojnë shpejt disa nga dëshmitë e inspektuara. Kontrolli i dëshmimeve për të verifikuar nëse ato kanë të evidentuar numrin e sirtarit apo kutisë në Regjistër, nxjerrë në pah që dhomat e dëshmimeve në Prishtinë Qendër, Prishtinë Jugu, Gjilan e Fushë Kosovë nuk kanë të evidentuar në Regjistër, lokacionin e dëshmimeve brenda dhomave të deponimit. Ndërsa, në databazë, zyrtarët përgjegjës të dhomave të dëshmimeve në Mitrovicë Veriu, Prishtinë Jugu, Prishtinë Qendër e Fushë Kosovë nuk kanë evidentuar secilin lokacion të dëshmimeve. Dëshmitë që janë shkatërruar me urdhëresa, apo që kanë qenë në laborator për ekzaminim janë konsideruar se kanë përmbushur standardin me PSO.

Rekomandimi nr. 11

IPK-ja u rekomandon zyrtarëve përgjegjës të dhomave të dëshmimeve në kuadër të stacioneve policore që të dhënat në regjistra të dëshmimeve dhe bazat elektronike të të dhënave duhet të jenë të regjistruara në mënyrë ekuivalente, si dhe dëshmitë të jenë lehtë të identifikueshme sipas një sistemi numerik, të evidentuar në regjistra dhe databaza (lokacioni).

3.4.9. Çdo lëvizje e dëshmisë, e dorëzuar në gjykatë, në ndonjë njësi tjetër, ose që i është kthyer pronarit apo personit të autorizuar, duhet të regjistrohet në Regjistër e databazë. Gjatë inspektimit të dëshmimeve ka rezultuar që disa nga dhomat e dëshmimeve kanë pasur mangësi në evidentimin e lëvizjeve të dëshmimeve. Në gjashtë (6) dhoma të dëshmimeve janë hasur lëvizje të 16 dëshmimeve pa u evidentuar në regjistra³⁶. Është përgjegjësi e zyrtarëve përgjegjës të dhomave të dëshmimeve që të regjistrojnë çdo lëvizje të dëshmimeve, me të gjitha informatat mbi pranim-dorëzimin dhe procedurat tjera, të cilave iu janë nënshtruar për t'iu shmangur humbjeve apo dëmtimeve.

³³ Dëshmitë e rasteve me nr. 2020-EA-1208 (Gjakovë) dhe 2019-EA-0388 (Fushë Kosovë).

³⁴ Dëshmitë e rasteve me nr. 2019-SA-252 (Mitrovicë Veriu) dhe 2020-AE-0030 (Fushë Kosovë).

³⁵ PSO - Dhomat e dëshmimeve-vendosja, trajtimi dhe ruajtja e sendeve, pasurisë dhe provave të konfiskuara, në nivel lokal e qendror të Policisë së Kosovës, fq.12.

³⁶ Gjilan (2/10), Gjakovë (2/10), Mitrovicë Veriu (2/10), Prishtinë Qendër (2/10), Prishtinë Jugu (3/10), Fushë Kosovë (5/10).

3.4.10. Qasja në dhomë të dëshmimeve dhe zonat e deponimit është e kufizuar vetëm për zyrtarin policor të dhomës së dëshmimeve. Çdo hyrje e personelit regjistrohet në Regjistrin e qasjes në dhomën e dëshmimeve. Regjistri është gjetur në të gjitha dhomat e dëshmimeve. Përgjegjës për plotësimin e tij është zyrtari përgjegjës i dhomës së dëshmimeve. Lidhur me sigurinë, askush tjetër nuk duhet të ketë qasje në çelësin e dhomës së dëshmimeve, përveç komandantit të stacionit³⁷. Inspektorët kanë verifikuar se si ruhen çelësat nga menaxherët policor dhe kanë gjetur që komandantet e shtatë (7) stacioneve (Gjilan, Ferizaj, Gjakovë, Pejë, Prishtinë Jugu, Prizren, Fushë Kosovë) kanë respektuar procedurën e kufizimit të qasjes në çelësat e dhomave të dëshmimeve. Komandanti i Stacionit Policor në Podujevë nuk ka respektuar kriterin që çelësi të jetë në zarf të mbyllur. Në Leposaviç, Mitrovicë Veriu dhe Mitrovicë Jugu, në çelësin e dhomës së dëshmimeve kanë qasje edhe shefat e hetimeve. Në Prishtinë Qendër, çelësi i dhomës së dëshmimeve mbahet nga zëvendës komandanti, pasi pozita e komandantit është e paplotësuar. Komandanti i Stacionit Policor - Prishtinë Veriu nuk mbanë çelës të dhomës së dëshmimeve. Në asnjë rast nuk është hasur në raporte mbi përdorimin e çelësit rezervë.

3.4.11. Dhomat e dëshmimeve duhet të jenë të siguruara mirë, ngase në to vendosen, trajtohen dhe ruhen sendet apo pasuria e konfiskuar, të cilat janë nën administrimin e njëjësive hetimore. Dhomat e dëshmimeve duhet të jenë të vendosura në vend të përshtatshëm brenda ndërtesave, të ndërtuara nga materiali i fortë, si blloqe betoni ose të ngjashme. Duhet të jenë të projektuara pa dritare, nëse ka dritare ato duhet të konstruktohen në atë mënyrë që të pamundësojnë hyrjen përmes tyre, po ashtu kondicionimi dhe tubat e sistemit ventilues nëse ekzistojnë në dhoma, duhet të jenë të konstruktuar që të pamundësohet hyrja përmes tyre. Dyert e dhomave të dëshmimeve preferohet të jenë të punuara apo përpunuara nga metali, kapëset nyjore të tyre duhet të jenë të montuara nga brendësia e dhomës. Inspektimi ka vënë në pah se të gjitha dhomat e kontrolluara janë të vendosura në hapësira të përshtatshme brenda objekteve, të vlerësuar si hapësira të sigurta dhe të veçanta brenda tyre. Dhjetë (10) nga 13 dhomat e inspektuara janë të vendosura në katin përdhësë, një (1) në katin e dytë dhe dy (2) në bodrum. Dhoma e dëshmimeve në Ferizaj është e vendosur në bodrum të objektit, ka nivel të lartë të lagështisë për shkak të depërtimit të ujërave të zeza brenda hapësirës së kësaj dhome, nuk është e pastër dhe ndriçimi është i dobët. Këto kushte në këtë hapësirë pamundësojnë zhvillimin e një procesi të rregullt të punës. Nga 13 dhoma të inspektuara, vetëm në Pejë, dhoma e dëshmimeve është e konstruktuar pa dritare, në Prishtinë Qendër dritarja nuk është e siguruar me grila, por ka të vendosur një dërrasë, ndërsa në Leposaviç ka dritare, por të pasiguar me grila. Sa i përket ngrohjes, kondicionimit dhe tubave të sistemit ventilues që janë të rëndësishme për mbajtje të dëshmimeve në gjendje të përshtatshme, të gjitha dhomat e dëshmimeve të inspektuara kanë sistem të ventilimit e kondicionimit, por në Gjilan, Ferizaj, Gjakovë, Mitrovicë Veriu, Leposaviç, Prishtinë Jugu dhe Prishtinë Qendër, ky sistem nuk është funksional. Ndërsa, sistemi i ngrohjes nuk është funksional në Ferizaj, Mitrovicë Veriu, Leposaviç e Prishtinë Jugu. Dyert e dhomave të dëshmimeve preferohet të jenë të punuara apo përpunuara nga metali, ose të jenë derë solide nga bërthama e drurit, kurse kapëset nyjore të tyre të jenë të montuara nga brendësia e dhomës. Në të gjitha dhomat e inspektuara dyert kanë qenë sipas standardit të kërkuar ato kanë qenë nga materiali i fortë ose të drurit të mbuluar dhe më një derë më grila hekuri për shkaqe të sigurisë. Mirëpo në gjashtë (6) nga 13 dhoma të inspektuara³⁸, kapëset nyjore nuk kanë qenë sipas standardeve të kërkuara, pasi kanë qenë të vendosura nga ana e jashtme dhe nuk kanë qenë të siguruara.

³⁷ PSO, dhomat e dëshmimeve-vendosja, trajtimi dhe ruajtja e sendeve, pasurisë dhe provave të konfiskuara, në nivel lokal e qendrorë të Policisë së Kosovës, fq.22.

³⁸ Gjakovë, Prizren, Leposaviç, Pejë, Prishtinë Veriu, Prishtinë Jugu, Podujevë.

3.4.12. Dhoma e dëshmimeve duhet të ketë të instaluar alarm të ndërhyrjes, i cili detekton kur hapet dera pa autorizim. Sistemi i alarmit duhet testuar çdo muaj dhe duhet mbajtur shënime në lidhje me këtë. Sistemi mund të aktivizohet nga detektorët e lëvizjes dhe siguron një regjistër të mirë afatgjatë për të gjitha hyrjet, me ç'rast duhet të bëhet edhe deponimi digjital i imazheve në procesor të serverit. Dhjetë (10) nga 13 dhomat janë të pajisur me sistem alarmi për të parandaluar hyrjet e paautorizuara. Funkcionaliteti i alarmit është testuar gjatë kohës së inspektimit dhe është gjetur që në Mitrovicë Veriu e Leposaviç kanë të instaluar një sistem të tillë, por i njëjti nuk është funksional. Në Gjakovë, Pejë dhe Prishtinë Qendër nuk është i instaluar sistemi i alarmit. Stacioni Policor në Podujevë ka të ndara dhomat e dëshmimeve në dy hapësira të ndryshme, në njëren ruhen armët e në tjetrën dëshmitë e tjera. Në dhomën ku mbahen dëshmi tjera nuk ka sistem alarmi. PSO ka paraparë që secila dhomë e dëshmimeve duhet të jetë e monitoruar me sistem të kamerave të vendosura në pjesët hyrëse të dhomave të dëshmimeve dhe në hapësirat e brendshme të tyre. Në të njëjtën kohë ky monitorim duhet të deponojë imazhet në procesorin e serverit. Të gjitha dhomat e dëshmimeve e kanë përmbushur këtë kriter, përjashtuar Stacionin Policor në Prizren dhe Pejë, ku aty nuk ka pasur të vendosura kamera para hyrjes në dhomë të dëshmimeve, kurse brenda hapësirave të deponimit kanë qenë të vendosura dhe funksionale ato. Dhoma e dëshmimeve duhet të jetë e pajisur me aparate për shuarjen e zjarrit, detektorë të tymit, solucion për larje urgjente të syve dhe lavamanët për mbajtjen e higjienës. Po ashtu, edhe frigoriferi është i domosdoshëm për ruajtjen e dëshmimeve-materieve të caktuara biologjike. Të gjitha dhomat e dëshmimeve të inspektuara kanë qenë të pajisura me aparate për shuarjen e zjarrit. Dhomat e dëshmimeve të inspektuara kanë qenë të pajisura po ashtu me detektor tymi, mirëpo në Mitrovicë Jugu dhe Gjakovë ky sistem ka qenë jashtë funksioni. Të gjitha dhomat e dëshmimeve janë të pajisura me frigorifer për ruajtjen e dëshmimeve-materieve biologjike. Në Dhomën e dëshmimeve në Prishtinë Qendër frigoriferi nuk është gjetur në Dhomën e dëshmimeve, i njëjti është mbajtur në zyrën e zyrtarit përgjegjës të dhomës së dëshmimeve. Në Prizren dhe Podujevë, dhomat janë të pajisura me lavaman, ndërsa të tjerat dhoma të dëshmimeve nuk janë pajisur me lavaman për mbajtjen e higjienës për zyrtarët të cilët menaxhojnë me sendet e deponuara.

Rekomandimi nr. 12

IPK-ja i rekomandon Drejtorit të Departamentit për Operacione që bashkë me Drejtorin e Departamentit të Shërbimeve Mbështetëse (Drejtoria për Menaxhimin e Objekteve dhe Drejtorinë për Teknologji Informative e Komunikim), të inspektojnë kushtet dhe funksionalitetin në disa nga dhomat e dëshmimeve dhe të ndërmarrin veprimet e nevojshme drejt përmirësimit të kushteve teknike dhe të sigurisë, përfshirë monitorimin, alarmin, detektorët, higjienën, etj.

3.4.13. Administrimi i dëshmimeve është përgjegjësi dhe trajtimi i tyre kërkon përkushtim dhe kujdes. Dëshmitë duhet mbikëqyrur në çdo kohë dhe metodat për kontrollin e tyre janë të ndryshme, por PSO parasheh disa prej tyre, përfshirë revizionin, inspektimin dhe inventarizimin. Revizioni është rishikim formal periodik verifikues për të vërtetuar korrektësinë dhe rrjedhën e punës në dhomat e dëshmimeve. Një revizion është inspektim i paanshëm i parimeve, procedurave dhe veprimeve për të përcaktuar nëse janë përcjellur standardet. Revizionin e bën shefi i hetuesisë (apo i autorizuari i Komandantit të Stacionit) së paku një herë në tre (3) muaj, në grupe të përzgjedhura në bazë të rastësisë të dëshmimeve me ndjeshmëri të lartë, siç janë: armët e zjarrit (5 sosh), bankënotat e falsifikuara apo sendet me vlerë (5 zarfe) dhe substanca të kontrolluara (10 pako). Prishtinë Jugu ka kryer një revizion në vitin 2019, mirëpo nuk ka dëshmi të mjaftueshme që tregojnë se janë bërë revizione në çdo 3 muaj. Stacionet tjera të inspektuara nuk kanë ofruar dokumente për të dëshmuar procese të revizionit të realizuara gjatë vitit 2019. Gjatë vitit 2020 Prizreni ka kryer katër revizione,

Peja - 2, Prishtinë Qendë - 3 dhe Prishtinë Jugu - 1. Në dhomat e dëshmime në Gjilan, Prizren, Prishtinë Qendër e Fushë Kosovë gjatë vitit 2021 është kryer vetëm nga një revizion deri në kohën e inspektimit të IPK-së. Në dhomat e dëshmime në Ferizaj, Gjakovë, Mitrovicë Jugu, Mitrovicë Veriu, Prishtinë Veriu, Leposaviç dhe Podujevë nuk është bërë revizion në çdo tre muaj në tre vitet e fundit. Komisionet në të gjitha rastet e revizionimit (përfshirë këtu Prishtinë Qendër dhe Fushë Kosovën) kanë përzgjedhur dëshmitë duke mos respektuar rregullat e përcaktuara. Moskryerja e revizioneve paraqet neglizhencë dhe joseriozitet të autoriteteve të stacioneve policore dhe kjo nuk i kontribuon trajtimit dhe ushtrimit të kontrollit kualitativ mbi dëshmitë.

3.4.14. Inventarizimi është regjistrim dhe verifikim i pranisë së sendeve/dëshmime të mbajtura në Dhomën e dëshmime në krahasim me regjistrat. Inventarizimi duhet të kryhet së paku një herë në vit, çdo herë kur ka ndërrim të personelit apo me kërkesë të Drejtorit Rajonal. Është siguruar një numër i raporteve tërë inventarizimit në dhomat e dëshmime për të verifikuar nëse kanë arritur të përmbushin obligimet në regjistrimin, evidentimin dhe verifikimin e sendeve në krahasim me regjistrat. Stacionet që kanë kryer inventarizim në dhomat e dëshmime janë Mitrovicë Jugu (për vitin 2019) dhe Gjakovë, Prizren (për vitet 2019, 2020), ndërsa Pejë dhe Prishtinë Veriu (për vitin 2020). Stacionet Policore në Gjilan, Ferizaj, Mitrovicë Veriu, Leposaviç, Prishtinë Jugu, Prishtinë Qendra, Podujevë dhe Fushë Kosovë nuk kanë realizuar inventarizime për periudhat në të cilat është shtrirë inspektimi. Mungesa e inventarizimit rritë pasigurinë mbi ekzistencën e të gjitha dëshmime në hapësirat e deponimit dhe dobësitë e evidentuara janë rezultat i neglizhencës.

3.4.15. Me qëllim të rishikimit të procesit të punës, sigurisë dhe kushteve, në të cilat punojnë zyrtarët policor, nivelit të pastërtisë, si dhe përfilljen e procedurave duke përfshirë edhe shikimin e regjistrave, Shefi i Sektorit të Hetimeve në stacion duhet të kryejë sa më shpesh inspektime të paparalajmëruara në dhomën e dëshmime. IPK rëndësi të posaçme u ka kushtuar dhe inspektimeve të kryera brenda dhomave të dëshmime. Në dhomat e dëshmime në Mitrovicë Jugu dhe Leposaviç janë kryer inspektime në vitet 2019 dhe 2021, ndërsa në Mitrovicë Veriu inspektime të tilla janë kryer në vitet 2020 dhe 2021, në Podujevë është kryer inspektim vetëm për vitin 2019, në Prishtinë Qendër janë kryer inspektime në vitin 2020, në Gjilan, Gjakovë, Prishtinë Veriu dhe Prishtinë Jugu, inspektime janë kryer në vitin 2021. Është gjetur se jo në kuadër të të gjitha stacioneve janë kryer inspektime në periudhën 2019, 2020 dhe 2021. Në Ferizaj, Prizren, Pejë dhe Fushë Kosovë nuk janë prezentuar raporte të inspektimit. Inspektimi ngritë përgjegjësinë, ngase aktivizon zyrtarët përgjegjës që të jenë më të përkushtuar. Mungesa e inspektimeve është rezultat i neglizhencës së shëfave të sektorëve të hetimeve për të ushtruar kontrollin e nevojshëm mbi dhomat e dëshmime.

Rekomandimi nr. 13

IPK-ja u rekomandon Drejtorëve Rajonal dhe komandantëve të stacioneve, që të sigurohen se në dhomat e dëshmime ushtrohen kontrole të brendshme përmes revizionit, inventarizimit, apo edhe inspektimeve të paparalajmëruara, drejt administrimit të duhur të dëshmime.

4. Plani i përmbushjes së rekomandimeve

4.1. Plani për përmbushjen e rekomandimeve

4.1.1. Mbi bazën e gjetjeve, IPK-ja ka dhënë një numër rekomandimesh dhe pas komenteve të ofruara nga menaxhmenti policor në takimin përmbyllës të datës 25.01.2022, është vendosur që ato të realizohen sipas Planit të Veprimit të prezantuar në tabelën e mëposhtme.

Nr.	Rekomandimi	Niveli i prioritetit	Komentet e strukturës policore	Plani i veprimit
1.	<i>IPK-ja u rekomandon Drejtorit të Departamentit për Operacione dhe Drejtorit të Departamentit të Burimeve Njerëzore që në koordinim me Divizionin e Trajnimit, drejtoritë rajonale (stacionet) të ndërmarrin veprimet e nevojshme që në kurset bazike të hetimit të krimit, si dhe trajtimit të dëshmive, të ketë përfshirje më të madhe të hetuesve nga sektorët hetimor të stacioneve policore</i>	-II-	<i>Kurset bazike për Hetimin e rasteve penale janë në vijimësi dhe se përpos Z/Policor Hetues në këto kurse dërgohen edhe Z/Policor patrullues në mënyrë që të shpërndahet njohuria bazike e hetimeve edhe në njësit tjera organizative të PK-ës. Ekziston mundësia që për një periudhë kohore të shkurtër kur kemi pranimit të Z/Policor në Njësit e Hetimeve që janë pa trajnim bazik por se të njejtit porsa të ofrohet mundësia dërgohen në trajnime të tilla. Sido që të jetë Departamenti i Operacioneve në bashkëpunim me Divizionin e Trajnimit do të koordinojnë aktivitetet e tyre që në trajnimin bazik të hetimeve të dërgojnë numër sa më të madhë të Z/Policorë. Gjithashtu Divizioni i Trajnimeve do të ketë parasysht që në të ardhmen të organizoj ndonjë lloj trajnimi lidhje me Z/Policorpë të cilët i mbikëqyrin dhomat e dëshmive</i>	<i>Në vazhdimësi</i>
2.	<i>IPK-ja i rekomandon Drejtorit të Departamentit për Operacione dhe Drejtorit të Departamentit për Burime Njerëzore, që në koordinim dhe bashkëpunim me Drejtorët Rajonal, të ndërmarrin veprime të nevojshme në kuadër të rishikimit funksional dhe organizativ, që stacionet policore të mund të sigurojnë kapacitete të mjaftueshme për hetimin dhe zbulimin e krimit, duke siguruar njëherit shpërndarje adekuate të</i>	-I-	<i>Drejtoria e Përgjithshme e PK-ës është në dijeni për çështjen e tillë dhe se në rishikim të strukturës së re organizative është parap një çështje e tillë të rregullohet dhe të rritet numri i zyrtarëve në ato njësi ku ka nevojë dhe të zvogëlohet aty ku nuk ka nevojë në mënyrë që të ketë proporcionalitet në shpërndarjen e rasteve për hetim por edhe angazhimeve tjera tek Z/Policorë.</i>	2022

	<i>burimeve, duke marrë parasysh dhe numrin e rasteve, apo nivelin e krimit në zonat e përgjegjësive së stacioneve dhe drejtorive rajonale.</i>			
3.	<i>IPK-ja u rekomandon përgjegjësve të bazës së të dhënave të Sistemit Informativ të Policisë së Kosovës (SIPK), që në të gjitha rastet e evidentimit të të dhënave kriminale mbi personat e lidhur me veprat penale, të jenë të kujdesshëm dhe të sigurohen se informatat regjistrohen saktë, duke u mbështetur në dokumente identifikimi të palëve.</i>	<i>-I-</i>	<i>Deri në një periudhë të vonshme kohore janë regjistruar në SIPK-ë të dhënat e personave pa dokument identifikimi por në kohën e fundit kjo çështje është tejkaluar, e do të shiqohet nëse në ndonjë nga Stacionet nuk është tejkaluar kjo çështje, do të tejkalohet më së voni në periudhën K2. Përmes një shkresë zyrtare do të njoftohen DRP-ët (SIPK) që rastet të cilat kanë mungesa në të dhëna të mos futen fare në sistem pa i plotësuar të dhënat në detaje (të kthehet rasti mbrapa deri në plotësim të të dhënave).</i>	<i>K-2 2022</i>
4.	<i>IPK-ja u rekomandon drejtuesve të Policisë së Kosovës që në situata kur personave të verifikuar nga Agjencia e Kosovës për Inteligjencë u del rezultati negativ, të ndërmarrin hapat e nevojshëm sipas nenit 27 të Ligjit nr. 03/L-178 për Klasifikimin e Informacioneve dhe Verifikimin e Sigurisë, në drejtim të moscenueshmërisë së integritetit të informatave.</i>	<i>-I-</i>	<i>Në secilin rast PK-ë është e kujdesshme dhe se vepron në baëz të rregullave të parapara. Për rastin konkret në Pejë do të adresohet çështja menjëherë dhe do të plotësohet rekomandimi i dhënë që në periudhën kohore K1.</i>	<i>K-1 2022</i>
5.	<i>IPK-ja u rekomandon Shefave të Sektorëve Hetimor të stacioneve, që të ushtrojnë kontroll më strikt në përmbushjen e obligimeve që dalin nga neni 70, paragrafi 5 i KPP-së, sipas së cilës dispozitë, Policia posa të ketë dyshim të arsyeshëm se është kryer veprë penale, brenda 24 orësh t'i dërgoj raport Prokurorit kompetent të Shtetit, i cili më pas vendosë nëse duhet filluar procedura penale lidhur me rastin.</i>	<i>-I-</i>	<i>Deri më tani Z/Policor posa kanë marrë njohuri dhe kanë marrë informatën e sakt lidhje me rastin, përmes telefonit e kanë njoftuar Prokurorin e Shtetit lidhje me rastin me ç'rast kanë marrë konfirmimin nga Prokurori i Shtetit për të filluar me hetimin, Polcia nga Prokuroria e Shtetit ka marrë konfirmimin lidhje me cilësimin e veprës penale, gjithashtu edhe përmes raportit të shpejtë apo 24 orësh është njoftuar edhe Kryeprokurori i Shtetit me të gjitha rastet dhe veprimet policore të ndërmarra në lidhje me rastet e paraqitura (mendojmë se kjo çështje e mbulon mirë rekomandimin e</i>	<i>Në vazhdimë si</i>

			<p>IPK-ës). Bashkëpunim me Prokurorin e Shtetit është rregulluar dhe është funksionale metoda e veprimit Polici – Prokurori. Deri më tani nuk kemi hasur në ndonjë problematik lidhur me çështjen e potencuar në këtë rekomandim.</p> <p>Në të ardhmen Menaxhmenti i PK-ës do të ketë takime me Prokurorin e Shtetit me ç'rast do të ketë bisedime të mirëfillta në rregullimin e kësaj çështjeje.</p>	
6.	<p>IPK-ja u rekomandon zyrtarëve policor të sektorëve të hetimeve të stacioneve policore, që me rastin e marrjes në pyetje, dëshmitarëve apo të dyshuarve t'iu lexohen paralajmërimet mbi të drejtat e tyre, konform dispozitave ligjore të Kodit të Procedurës Penale, dhe në fund të marrjes në pyetje, procesverbalet të mos procedohen pa nënshkrimin e palëve.</p>	-I-	<p>Tek Z/Policor Hetues kjo çështje është e rregulluar dhe funksionale por nëse është hasur në ndonjë deklarat në të cilën nuk janë lexuar të drejtat e personave atëherë ekziston mundësia e marrjes së asaj deklarate në vendin e ngjarjes nga ana e Njësive patrulluese, Sektoriale apo ndonjë njësie tjetër organizative në kuadër të PK-ës dhe se rasti është dërguar në Njësien e Hetimeve. Menaxhmenti i PK-ës do të sigurohet që pavarësisht njësive të cilat merren me rastin kjo formë e të drejtave të mos mungoj në asnjë rast. Në këtë drejtim mbikëqyrësit do të angazhohen në kontrolle më të shtuara të lëndëve në mënyrë që në asnjë rast të mos kalohet çështja e leximit të të drejtave.</p>	Në vazhdimësi
7.	<p>IPK-ja u rekomandon Shefave të Sektorëve të Hetimeve në kuadër të stacioneve policore, që pas kryerjes së veprimeve hetimore dhe kompletimit të procesit të hetimit, dosjet para dorëzimit në Prokuroritë kompetente t'i nënshtrihen kontrollit dhe më pas të nënshkruhen nga mbikëqyrësit e vijës së parë dhe përmes tyre, nga shefat e njësive hetimore, apo zëvendësit e tyre.</p>	-I-	<p>Në njësitë e Hetimeve ekziston hierarkia komanduese ku Shefi i Njesisë menaxhon me njësien dhe në çdo ekip ekziston nga një mbikëqyrës i vijës së parë i cili është në qdo kohë me Z/Policor Hetues dhe gjatë periudhës kohore derisa Shefi i Njesisë nuk është në detyrë (pas orarit të rregullt apo ditëve të vikendit) mbikëqyrësit e vijës së parë janë zëvendësues të Shefit të Hetimeve. Duke u bazuar në të lartcekurat mbikëqyrësi i vijës së parë (rreshteri) e ka për obligim nënshkrimin e rasteve dhe procedimin e tyre tutje.</p> <p>Shefi i Njesisë tani e tutje do të ketë kontroll të shtuar në rastet, me</p>	K-1 2022

			qëllim që asnjë rast mos të përcillet në Prokurorin e Shtetit pa nënshkrimin e mbikëqyrësit të vijës së parë.	
8.	IPK-ja u rekomandon zyrtarëve përgjegjës të dhomës së dëshmime në Stacionin Policor në Ferizaj që të gjitha dëshmitë dhe sendet e konfiskuara të ruhen brenda hapësirave të dhomës së dëshmime, po ashtu bankënotat dhe gjërat e çmuara të deponohen në sef, apo arkë metali brenda zonës së deponimit të sendeve dhe dëshmime.	-I-	Menaxhmenti i lartë në Ferizaj ka marrë të gjitha masat e nevojshme për implementimin e këtij Rekomandimi andaj personat përgjegjës kanë filluar të fusin në implementim rekomandimin e dhënë.	K-1 2022
9.	IPK-ja u rekomandon zyrtarëve përgjegjës të dhomave të dëshmime në kuadër të stacioneve policore, që me rastin e pranimit të dëshmime nga hetuesit e rasteve, të sigurohen se dëshmitë janë të mbyllura dhe të paketuara në paketime adekuate, dhe të njëjtat të ruhen në vende të posaçme, varësisht nga specifikat e tyre me qëllim të ruajtjes nga dëmtimet e mundshme.	-I-	Menaxhmenti i PK-ës do të shtoj kontrollat e jashtzakonshme në mënyrë që ky rekomandim të gjejë zbatim në periudhën e parë K1 të vitit 2022.	K-1 2022
10.	IPK-ja u rekomandon zyrtarëve përgjegjës të dhomave të dëshmime në kuadër të stacioneve policore (Prishtinë Qendër, Prishtinë Veriu, Prishtinë Jugu dhe Fushë Kosovë), që në asnjë rast të mos pranojnë dhe mbajnë sende, që nuk janë të sekuestruara/konfiskuara konform dispozitave të Kodit të Procedurës Penale.	-I-	Sendet sekuestruara/konfiskuara, sekuestrohen/konfiskohen me urdhër të Prokurorit të Shtetit. PK-ë e ka të pamundur që për sendet për të cilat ep urdhër Prokurori i Shtetit për sekuestri/konfiskim të mos i sekuestroj/konfiskoj dhe ti lë jashta dhomave të dëshmime. Por nëse ka dëshmi të tilla të cilat me urdhër të Prokurorit të Shtetit janë sekuestruar/konfiskuar atëherë PK-ë në afatin sa më të shkurtër kohor i përpilon shkresat e nevojshme dhe i dërgon në organet përgjegjëse që ato dëshmi të ruhen në vende tjera apo të shkatërrohen nëse nuk është e nevojshme për procedur të tutjeshme. Menaxhmenti i PK-ës do të ndërmerr të gjitha veprimet e parapara me legjislacionin në fuqi lidhur me ruajtjen e armëve .	2022
11.	IPK-ja u rekomandon zyrtarëve përgjegjës të dhomave të dëshmime	-I-	Dhoma e dëshmime e ka një regjistër elektronik dhe atë fizik të mbajtjes së	K-1 2022

	në kuadër të stacioneve policore që të dhënat në regjistra të dëshmime dhe bazat elektronike të të dhënave duhet të jenë të regjistruara në mënyrë ekuivalente, si dhe dëshmitë të jenë lehtë të identifikueshme sipas një sistemi numerik, të evidentuar në regjistra dhe databaza (lokacioni).		evidencave të dëshmime të sekuestruara/konfiskuara. Por se në disa raste të viteve të mëhershme nuk ka mundur të i shënoj në këto evidenca andaj kanë mbetur të pa evidentuara. Autoritetet përgjegjëse do të shtojnë kontroll të veçantë në këtë fushë duke bërë inspektime të jashtëzakonshme në dhomat e dëshmime lidhje me zbatimin e këti rekomandimi dhe në përmbushjen e detyrave ashtu siç e parasheh PSO për Dhomat e Dëshmime.	
12.	IPK-ja i rekomandon Drejtorit të Departamentit për Operacione që bashkë me Drejtorin e Departamentit të Shërbimeve Mbështetëse (Drejtoria për Menaxhimin e Objekteve dhe Drejtorinë për Teknologji Informative e Komunikim), të inspektojnë kushtet dhe funksionalitetin në disa nga dhomat e dëshmime dhe të ndërmarrin veprimet e nevojshme drejt përmirësimit të kushteve teknike dhe të sigurisë, përfshirë monitorimin, alarmin, detektorët, higjienën, etj.	-I-	Në pothuajse të gjitha dhomat e dëshmime janë të instaluar kamerat dhe alarmi, por se ka në disa dhoma të dëshmime që për shkak të rrethanave në të cilat gjenden e kanë të pa mundur instalimin e llavabovë (për pastrimin e duarve apo gjërave tjera) për shkak të largësis së rrjetit të ujsjellësit. Menaxhmenti i PK-ës do të marr të gjitha masat e nevojshme që në ato dhoma të dëshmime ku kanë defekte në alarme dhe kamera të sanohen ato defekte.	K-2 2022
13.	IPK-ja u rekomandon Drejtorëve Rajonal dhe komandantëve të stacioneve, që të sigurohen se në dhomat e dëshmime ushtrohen kontrole të brendshme përmes revizionit, inventarizimit, apo edhe inspektimeve të paparalajmëruara, drejt administrimit të duhur të dëshmime.	-I-	Të gjitha DRP-ët janë të obliguara që të kenë së paku dy inspektime të aranzhuara për të bërë kontrole të brendshme lidhje me inventarizimin dhe regjistrimin e dëshmime në dhomat e dëshmime. Tani e tutje do të ketë edhe kontrole dhe inspektime të jashtëzakonshme lidhje me çështjen e potencuar në rekomandimin e IPK-ës. Menaxhmenti i lartë i PK-ës do të kërkoj Planin e Veprimit nga DRP-ët lidhje me inspektimet që do të ndërmerren nga DRP-ët në këtë çështje gjithashtu do të kërkoj edhe Raportet përmbyllëse pas inspektimeve dhe në fund vit do të kërkoj raport përmbyllës lidhje me implementimin e Planit të veprimit nga DRP-ët.	2022

Vepra penale sipas Kodit Penal të Republikës së Kosovës	Neni
<i>Nxitja e përçarjes dhe mosdurimit</i>	141.1
<i>Kanosja</i>	181.1, 181.2
<i>Ngacmimi</i>	182.1, 182.2
<i>Ngacmimi seksual</i>	183.1
<i>Sulm</i>	184.1 - 184.3
<i>Lëndim i lehtë trupor</i>	185.1 - 185.3
<i>Lëndim i rëndë trupor</i>	186.1
<i>Pjesëmarrje në rrahje</i>	187
<i>Mosdhënie e ndihmës</i>	188.1 - 188.3
<i>Braktisja e personave të paaftë</i>	189.1, 189.2
<i>Shkelja e statusit të barabartë të shtetasve dhe banorëve të Republikës së Kosovës</i>	190.1 - 190.3
<i>Shtrëngimi</i>	192.1
<i>Privimi i kundërligjshëm i lirisë</i>	193.1
<i>Keqtrajtimi gjatë ushtrimit të detyrës zyrtare dhe autorizimeve publike</i>	195
<i>Cenimi i paprekshmërisë së banesave dhe objekteve</i>	197
<i>Përgjimi i paautorizuar</i>	201.1
<i>Fotografimi dhe incizimi tjetër i paautorizuar</i>	202.1, 202.2
<i>Parandalimi ose pengimi i tubimit publik</i>	204.1
<i>Cenimi i së drejtës për ushtrimin e mjetit juridik</i>	205.1
<i>Cenimi i të drejtave në marrëdhëniet e punës</i>	218
<i>Cenimi i të drejtave të punësimit dhe të punësisë</i>	219
<i>Cenimi i së drejtës në menaxhim</i>	220.1, 220.2
<i>Cenimi i së drejtës në grevë</i>	221.1
<i>Keqpërdorimi i së drejtës së grevës</i>	222.1
<i>Cenimi i së drejtës nga sigurimi social</i>	223
<i>Sulm seksual</i>	229.1, 229.2
<i>Degradimi i integritetit seksual</i>	230.1, 230.2
<i>Bigamia</i>	237
<i>Martesa e detyruar</i>	239.1
<i>Ndryshimi i statusit familjar të fëmijës</i>	241
<i>Marrja dhe mbajtja e kundërligjshme e fëmijës</i>	242.1, 242.2
<i>Keqtrajtimi apo braktisja e fëmijës</i>	243.1 - 243.4
<i>Shkelja e detyrimeve familjare</i>	244.1, 244.2
<i>Shmangia nga sigurimi i mjeteve të jetesës</i>	245.1
<i>Pengimi dhe mosekzekutimi i masave për mbrojtjen e fëmijëve</i>	246.1
<i>Mosraportimi i abuzimit të fëmijës</i>	247.1, 247.2
<i>Dhuna në familje</i>	248
<i>Përhapja e sëmundjeve ngjitëse</i>	249.1 - 249.3
<i>Mosveprimi sipas dispozitave shëndetësore gjatë epidemisë</i>	250
<i>Përhapja e sëmundjeve venerike</i>	251.1, 251.2
<i>Punesimi i personave të infektuar me sëmundje ngjitëse</i>	253.1 - 253.4
<i>Trajtimi i pandërgjegjshëm mjekësor</i>	254.1, 254.2
<i>Mosdhënia e ndihmës mjekësore</i>	255.1
<i>Ushtrimi i kundërligjshëm i veprimtarisë mjekësore ose farmaceutike</i>	256.1
<i>Përgatitja dhe dhënia e pandërgjegjshme e barnave</i>	258.1, 258.2
<i>Kontrolli i papërgjegjshëm i produkteve shtazore të destinuara për konsumim</i>	262.1 - 262.4
<i>Dhënia ose përdorimi i certifikatës së rreme të mjekut apo veterinarit</i>	263.2
<i>Ndotja e ujit të pijshëm</i>	264.1, 264.2
<i>Ndotja e artikujve ushqimorë që përdoren nga njerëzit apo kafshët</i>	265.1, 265.2

<i>Shërbimi me pije alkoolike të personave nën moshën 16 vjet</i>	266.1, 266.2
<i>Posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge</i>	269.1
<i>Organizimi i skemave piramidale dhe bixhozit të paligjshëm</i>	294.2
<i>Falsifikimi i parasë</i>	296.3, 296.4
<i>Vjedhje</i>	313
<i>Vjedhja e shërbimeve</i>	314
<i>Vjedhje e rëndë</i>	315.1, 315.2
<i>Vjedhje grabitqare</i>	316.1
<i>Grabitja</i>	317.1
<i>Shpërdorimi i pasurisë së huaj</i>	318.1, 318.2, 318.5, 318.6
<i>Marrja në posedim e pasurisë së luajtshme</i>	319.1, 319.2
<i>Uzarpimi i paligjshëm i pronës së paluajtshme</i>	320.1 - 320.3
<i>Asgjësimi apo dëmtimi i pasurisë</i>	321.1, 321.2
<i>Zjarrvënie</i>	322.1, 322.2
<i>Mashtrimi</i>	323.1, 323.5
<i>Detyrimi</i>	328.1
<i>Shantazhi</i>	329.1
<i>Keqpërdorimi i besimit</i>	330.1, 330.2
<i>Fajdja</i>	331.1
<i>Dëmtimi i të drejtave pronësore të personit tjetër</i>	322.1
<i>Blerja, pranimi ose fshehja e sendeve të përfituara me kryerjen e veprës penale</i>	333
<i>Cenimi i paprekshmërisë së mjeteve motorike</i>	334.1, 334.2
<i>Ndotja, degradimi ose shkatërrimi i mjedisit</i>	338.1, 338.2
<i>Mbajtja e paligjshme e substancave dhe e mbeturinave të rrezikshme</i>	339.1 - 339.4
<i>Prodhimi, shitja e vënja në qarkullim e materieve të dëmshme për mjekim të shtazëve</i>	342
<i>Dhënia e ndihmës veterinarë në mënyrë të pandërgjegjshme</i>	343
<i>Moszbatimi i urdhrave për luftimin e sëmundjeve të shtazëve dhe bimëve</i>	345
<i>Keqtrajtimi i shtazëve dhe ndotja e ushqimit dhe ujit të shtazëve</i>	346
<i>Shkatërrimi i botës bimore me materie të dëmshme</i>	347
<i>Shkatërrimi i pyjeve</i>	348
<i>Shkaktimi i rrezikut të përgjithshëm</i>	356.1, 356.2
<i>Vjedhja e pyllit</i>	349
<i>Gjuetia e kundërligjshme</i>	350
<i>Peshkimi i kundërligjshëm</i>	353
<i>Asgjësimi, dëmtimi ose heqja e instalimeve publike</i>	357.1, 357.2
<i>Asgjësimi, dëmtimi ose heqja e pajisjeve mbrojtëse dhe rrezikimi i sigurisë në vendin e punës</i>	358.1 - 358.3
<i>Ndërtimi pa leje</i>	359.1
<i>Punimet ndërtimore të kundërligjshme</i>	360.1, 360.2, 360.3, 360.5
<i>Dërgimi ose transportimi i kundërligjshëm i lëndëve ekskluzive ose lëndëve ndezëse</i>	361
<i>Mosevitim i rrezikut</i>	362
<i>Keqpërdorimi i sinjalit të fatkeqësisë apo të rrezikut</i>	363
<i>Fshirja, heqja apo ndryshimi i kundërligjshëm i shenjave në armë zjarri apo municion</i>	365.1, 365.2
<i>Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim i paautorizuar i armëve</i>	366.1
<i>Përdorim i armës apo mjetit të rrezikshëm</i>	367.1, 367.2
<i>Lejet, pëlqimet dhe licencat e rreme të armëve dhe dhënia e informatave të rreme</i>	368.1, 368.3
<i>Rrezikim i trafikut publik</i>	370.1, 370.2
<i>Ngasje në gjendje të paaftë apo të dehur</i>	371.1
<i>Rrezikimi i trafikut publik me veprim apo mjete të rrezikshme</i>	372.1
<i>Mbikëqyrja e pandërgjegjshme e trafikut publik</i>	373.1

<i>Mosdhënia e ndihmës personit të lënduar në fatkeqësinë e trafikut publik</i>	374.1
<i>Keqpërdorimi i sinjaleve ndërkombëtare të komunikacionit</i>	375
<i>Moslajmërimi i përgatitjes së veprës penale</i>	377.1
<i>Moslajmërimi i veprës penale ose kryesit të tyre</i>	378.1
<i>Dhënia e ndihmës kryerësve pas kryerjes së veprës penale</i>	380.1
<i>Lajmërimi apo kallëzimi i rremë</i>	382.1 - 382.4
<i>Deklarimi i rremë nën betim</i>	383.1, 383.2
<i>Deklarimet e rreme</i>	384
<i>Deklaratat e rreme të dëshmitarëve bashkëpunues</i>	385
<i>Pengimi i të provuarit apo procedurës zyrtare</i>	386.1 - 386.5
<i>Hakmarrje</i>	388.1, 388.2
<i>Manipulimi me prova</i>	389
<i>Falsifikimi i dokumenteve</i>	390.1
<i>Shkelja e fshehtësisë së procedurës</i>	392.1
<i>Mospërfillja e gjykatës</i>	393.1
<i>Mosekzekutimi i vendimeve gjyqësore</i>	394.1
<i>Legalizimi i përmbajtjes së rreme</i>	395
<i>Rrebelim i personave të privuar nga liria</i>	396.1, 396.2
<i>Arratisja e personit të privuar nga liria</i>	397.1
<i>Mundësimi i kundërligjshëm i ushtimit të profesionit, veprimtarisë ose detyrës</i>	400
<i>Pengim i personit zyrtar në kryerjen e detyrës zyrtare</i>	401.1 - 401.3
<i>Sulm ndaj personit zyrtar</i>	402.1 - 402.3
<i>Thirrje për rezistencë</i>	403.1, 403.2
<i>Pjesëmarrje në turrme që kryen vepër penale dhe huliganizëm</i>	404.1 - 404.3
<i>Mospjesëmarrja në mënjanimin e rrezikut të përgjithshëm</i>	405
<i>Heqja apo dëmtimi i vulave zyrtare apo shenjave</i>	406
<i>Marrja apo asgjësimi i vulave zyrtare apo shkresave zyrtare</i>	407.1
<i>Prezantimi i rremë si person zyrtar</i>	409
<i>Vetgjyqësia</i>	410.1 - 410.3
<i>Dhënia e kundërligjshme e ndihmës juridike</i>	411
<i>Pengimi i ceremonive fetare</i>	412
<i>Dëmtimi i varreve apo kufomave</i>	413.1
<i>Arkëtimi dhe pagesa e paligjshme</i>	428.1, 428.3